



Draft–Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit

2015 -2020

Kapitulli 1: Kushtet aktuale

Cilesia e ajrit

*Cilësia e ajrit*¹ në zonat kryesore urbane është përmirësuar mesatarisht në masën 30 %, por problematike ngelet shkalla e ekspozimit të popullatës ndaj ndotjes, si pasojë e tejkalimit të normës vjetore të ditëve të ndotura². Përmirësimet në cilësinë e ajrit lidhen kryesisht me përmirësimin e infrastrukturës rrugore në zonat urbane.

Ndotja nga sektori i transportit, lidhet me numrin e madh të automjeteve që nuk plotësojnë standartet e shkarkimeve në ajër, cilësia e lëndës djegëse që përdorin, viti i prodhimit të tyre, si dhe përdorimi i automjeteve me motor pa konvertor katalitik duke favorizuar rritjen e përmbajtjes së pluhurit si dhe shkarkimet e gazta gjatë djegjes së karburantit.

Kontrolli i cilësisë së lëndës djegëse, vecanerisht për përmbajtjen e squfurit dhe plumbit në lëndët djegëse është rregulluar nëpërmjet VKM Nr.147, datë 21.3.2007 "Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diezel" dhe VKM nr. 781, datë 14.11.2012 "Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme të lëngshme për përdorim termik civil dhe industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)". Këto akte përcaktojnë standartet dhe specifikime teknike për lëndët djegëse që duhet të përdoren për automjetet dhe qelime termike; Zbatimi i legjislacionit për kontrollin e cilësisë së lëndës djegëse.

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës monitoron shkarkimet e gazrave nga automjetet që kalojnë në kontroll teknik sipas Udhëzimit Nr. 2, datë 11.02.2010 "Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore" (shkalla e opacitetit si tregues mesatar i shkarkimeve të gazrave në mjetet me naftë dhe përmbajtja e CO/HC për mjetet me benzinë). Nga rezultatet e matjeve të deritanishme konstatohet se akoma një numër i madh mjetesh i kalojnë normat e lejuara. Parashikohet që për një periudhë 2 vjeçare këto norma të bëhen të detyrueshme, kohë gjatë së cilës drejtuesit e mjeteve do të nxiten për të përdorur pajisjet teknike për reduktimin e shkarkimeve të mjeteve sic janë: filtrat apo marmitat katalitike.

Me rritjen e transportit automobilistik, sipas tendencës së deri tanishme edhe përmbajtja e NO₂ mund të arrijë vlerën kufi të lejuar, së pari në qytetet e Tiranës dhe Durrësit, e më radhë në qytetet e tjera brenda një harku kohor 3-5 vjet. Për ta ndërprerë këtë tendencë rritëse të ndotjes nga transporti automobilistik, një ndërhyrje efektive në planifikimin urban të qyteteve respektive, ku të merret parasysh optimizimi i trafikut, reduktimi i numrit të makinave që qarkullojnë në ato rrugë ku problemet me cilësinë e ajrit janë më të mëdha, përmirësimi i transportit publik për të zëvendësuar makinat private dhe përdorimi i mjeteve alternative të transportit rrugor, kontrolli i shkarkimeve të gazeve nga automjetet, etj si dhe rritja e sipërfaqeve të gjelberuara.

Zonat industriale kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në ndotjen e ajrit. Matjet e cilësisë së ajrit kanë treguar probleme serioze për grimcat në Elbasan të shkaktuara nga industria metalurgjike, fabrika e cimentos dhe nga depozita të hapura të krijuara nga aktivitetet të mëparshme industriale.

Në zonën e Fierit matjet indikative kanë regjistruar probleme serioze të shkaktuara nga industria

¹ PM_{2,5} dhe PM₁₀, SO₂, NO₂, CO, Pb, O₃, dhe benzenit

² Sipas standartit të BE, numri i ditëve me ndotje mbi nivelin e lejuar është 35 ditë në vit

prezente dhe e meparshme e naftes. Shume "pellgje vajrash" ne zonen e Fierit kontribuojne ne nje emetim te konsiderueshem te hidrokarbureve.

Ne afersi te industrive te medha ekzistojne probleme me cilesine e ajrit te mjedisit, prandaj kontrolli i monitorimit te pershtatshem, te shkarkimeve nga kompanite industriale duhet te forcohet.

Gjithashtu aktivitetet e ndertimit dhe zvogelimi i sipërfaqeve të gjelbërta per shkak te ndertimeve kanë ndikuar negativisht në ndotjen e ajrit urban.

Per te adresuar disa nga problemet me siper, gjate vitit 2014 jane ndermarre disa nisma ligjore qe lidhen me cilesine e ajrit te mjedisit dhe me sistemin e taksave per lendet djegese. VKM nr. 594, date 10.09.2014, miratoi Strategjine Kombëtare te Cilësisë së Ajrit të Mjedisit dhe Ligjin nr. 162, date 04.12.2014 " Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit të mjedisit".

Paketa e re fiskale për vitin 2015 ka parashikuar që të ketë një rritje të taksës së qarkullimit për karburantet me 10 lekë për secilën kategori. Për vitin 2015 do të ketë një çmim unik për taksën e qarkullimi e cila do të jetë 27 lekë/litër, si për benzinën ashtu edhe për gazoilin. Paketa e re fiskale pritet te sjelli permiresime ne cilesine e ajrit te mjedisit.

Megjithë perpjekjet ne vite per te permiresuar sistemin e monitorimit te cilesise se ajrit, praktika e tanishme e monitorimit nuk eshte ne linje me kerkesat e BE. Stacionet automatike te monitorimit prodhojne te dhena te perqendrimeve te cilesise se ajrit por Siguria dhe Kontrolli i Cilesise se te dhenave QA/QC nuk eshte aplikuar ndonjehere, me perjashtim te dy stacioneve automatike te Tiranes qe menaxhohen nga ISHP gjate periudhes 2011-2013.

Sigurimi i Cilesise eshte i nevojshem nese te dhenat do te konsiderohen te pranueshme dhe do te perdoren per krijimin e informacionit qe duhet per menaxhimin e cilesise se ajrit.

Ka shume burime te ndotjes se ajrit ne Shqiperi; sektoret kryesore kontribues jane ai i transportit, industria, bujqesia, perdorimi shtepiak i produkteve si dhe ngrohja. Te gjithë keto sektore clirojne nje shumellojshmeri ndotesash si dioksid squfuri, okside te azoti, substance organike volatile si dhe lende grimcore.

Sfidat per te ardhmen synojne përmirësimin e cilësisë së ajrit urban përmes:

1. Miratimit dhe zbatimit te plotë te standardeve evropiane të cilësisë së ajrit urban dhe të
2. shkarkimeve në ajër
3. Miratimit dhe zbatimit te planeve të veprimit të cilësisë së ajrit në nivel kombetar dhe lokal
4. Konsolidimit te Sistemit Kombëtar të Monitorimit sipas standardeve europiane
5. Forcimit te zbatimit të legjislacionit vecanerisht mbi kontrollin e shkarkimeve nga automjetet, shkarkimet industriale, cilesine e lendes djegese
6. Bashkepunimit me pushtetin vendor per miratimin dhe zbatimin e planeve te veprimit te cilesise se ajrit
7. Forcimit te bashkepunimit me institucionet e linjes per integrimin e politikave te cilesise se ajrit ne politikat sektoriale te tyre.
8. Forcimi i iniciativave mbi taksat e automjeteve per te patur nje sistem automjetesh miqesore me mjedisin.

9. Nje planifikim me i mire, menaxhim me i mire dhe menyra me te mira te perdorimit te progresit teknologjik ne sektoret e industrise dhe transportit;
10. Investimi ne edukimin dhe ndergjegjesimin e publikut per te influencuar keshtu ne sjelljen individuale ne perdorimin e transportit alternativ etj;

Ndryshimet klimatike

Ndikimet nga ndryshimeve klimatike paraqesin sfida të rëndësishme për Shqipërinë, në mënyrë të veçantë për të perballuar ndikimet ne energji, ujera, bujqesi, shendetesi, turizem, biodiversitetet dhe ne mirëqenien e komunitetit lokal.

Komunikimi i Dytë Kombëtar (i Shqipërisë parashtron parashikimet klimatike për vendin, si në shkallë kombëtare, ashtu edhe në bazë sezoni. Tendencat e përgjithshme nga kjo analizë tregojnë se temperatura në Shqipëri pritet të rritet dhe reshjet parashikohet të bien, duke rezultuar në dimra më të butë, pranvera më të ngrohta, verë më të nxehtë dhe më të thatë dhe vjeshtë me të thatë.

Bujqësia është një sektor tepër i ndjeshëm ndaj ndryshimeve të klimës dhe një pjesë e mirë e popullësisë rurale të Shqipërisë është vulnerabël ndaj ndryshimeve klimatike. Të dhënat historike tregojnë se Shqipëria karakterizohet nga një klimë tepër e ndryshueshme që ka përjetuar një rritje të temperaturës mesatare, me ditë të një të nxehti ekstrem, dhe evapotranspirim (thatësiirë).

Parashikimet klimatike për të ardhmen tregojnë, mesatarisht, se Shqipëria do të përballet me këto fenomene³:

1. Një rritje me 2°C të temperaturës mesatare vjetore në dimër dhe verë deri në vitin 2049;
2. Rënie të rreshjeve mesatare me 8% deri në vitin 2049;
3. 28% rënie te disponueshmërisë vjetore të ujërave për drithërat deri në vitin 2050;
4. Rritje të përgjithshme të numrit total të ditëve të njëpasnjëshme të thata dhe një ulje të përgjithshme të numrit të ditëve të acarta deri në vitin 2049;
5. Rritje të Indeksit të Kohëzgjatjes së Valës së të Nxehtit me 20 ditë deri ne vitin 2049;
6. Rritje të eskpozimit ndaj insekteve të reja të dëmshme dhe sëmundjeve të reja për drithërat bujqësore dhe blegtorinë për shkak të ndryshimeve të temperaturës dhe regjimit të rreshjeve.

Gjatë krahasimit të vulnerabilitetit të Shqipërisë ndaj ndryshimeve klimatike me vendet evropiane me të ardhura të larta (për ato kategori për të cilat disponohen të dhëna), diferencat janë të theksuara, ku vendet evropiane me të ardhura të larta kanë mesatarisht 4.5% të popullësisë së punësuar në bujqësi në krahasim me Shqipërinë ku kjo shifër është 58%. Po ashtu, GDP-ja mesatare e përfutur nga bujqësia për Shqipërinë është 21% - shifër kjo shumë më e lartë sesa mesatarja prej 2% në vendet evropiane me të ardhura të larta⁴.

Shqipëria është anëtarësuar në Konventen Kuader te Kombeve te Bashkuara per Ndryshimet Klimatike (KKKBNK), ne janar 1995 dhe në Protokollin e Kiotos, Janar 2005. Si vend në Aneksin jo I të KKKBNK, Shqipëria nuk ka detyrime të percaktuara për të reduktuar shkarkimet e gazeve serrë. Si pale ne KKKBNK ka permbushur detyrimet, nepermjet hartimit te Komunikimeve Kombetare,

³ Burimi: “Shqipëria ndryshimet klimatike dhe bujqesia permbledhje shkurt 201 www.worldbank.org/eca/climateandagriculture

⁴Treguesit e Zhvillimit Botëror, 2009, Banka Botërore

perkatesisht Komunikimin e Pare Kombetar (2002) Komunikimi i Dytë Kombëtar (2009) dhe eshte ne proces hartimi i Komunikimit te Trete Kombetar, qe parashikohet te finalizohet gjate vitit 2015.

Qe prej vitit 2009, ne takimin e paleve te Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK) te zhvilluara ne Kopenhagen COP 15, dhe ne vijim, Shqipëria, ka mbeshetur qendrimin e Bashkimit Evropian dhe komunitetin ndërkombëtar për gjithpërfshirjen e të gjitha Palëve të Konventës në arritjen e një Marrëveshjeje të detyrueshme ne Paris 2015 per reduktimin e gazeve me efekt serrë.

Shqipëria ka filluar procesin e ndryshimit te statusit nga nje vend ne zhvillim ne nje vend te zhvilluar, ne kontekstin e Konventes per Ndryshimeve Klimatike. Ky proces eshte pjese integrale e procesit te integritit ne Bashkimit Evropian dhe perfshin zhvillimin e kapacitetve ne nivel kombetar per monitorimin dhe raportimin vjetor te Gazeve me Efekt Serre (GHG), formulimin dhe zbatimin e politikave per reduktim te GHG dhe adaptim ndaj ndryshimeve klimatike, transpozimin dhe zbatimin e *acquis* te Bashkimit Evropian lidhur me ndryshimet klimatike, perfshire zbatimin e masave kombetare te pershtateshme per reduktim te GHG (NAMA-s).

Ne linje me objektivat e BE 20-20-20, Shqipëria ka percaktuar objektiva sasiore lidhur me eficiencen e energjise (rritje me 9%) dhe burimet e energjive te rinovueshme (rritje deri ne 38%) ne kuader te Traktatit te Komunitetit te Energjise.

Në takimin e Palëve të UNFCCC-së që do të mbahet në Paris në fund të vitit 2015, COP21 të, qeveria shqiptare është angazhuar per te prezantuar kontributin kombetar për reduktimin e shkarkimeve të Gazeve me efekt Serrë (INDC).

Integrimi i çeshtjeve te ndryshimeve klimatike ne politikat sektoriale mbetet nje sfide. Egzistojne pengesa të rëndësishme per te adresuar kete sfide:

- (i) mungesa e nje kuadri ligjor per adaptim ndaj këtyre ndryshimeve, që pengon zbatimin e masave afatagjata e të qendrueshme
- (ii) mungesa e kapaciteteve institucionale për të vlerësuar ndikimet e ndryshimeve klimatike dhe pastaj per te aplikuar këtë informacion teknik për mobilizimin e zgjedhjeve programatike në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm.

Ka një nevojë urgjente për të ndërtuar kapacitetete dhe për të krijuar bazat për t'u përgjigjur në mënyre proaktive nevojës për adaptim ndaj ndryshimeve te klimes, e ne menyre te veçante ne procesin e planifikimit.

Per adresimin e ndryshimeve klimatike disa institucione kombetare ne bashkepunim me donatoret kane ndermarre nisma konkrete ne hartimin e studimeve dhe dokumentave strategjike:

Ministria e Shendetesise me mbeshtetjen e Organizates Boterore te Shendetesise ka hartuar dokumentin strategjik “Per pershtatjen e sistemit shendetesor ndaj ndryshimeve te klimes 2011-2021”, që perfshin drejtimet strategjike dhe planin e veprimit per periudhen 2011-2021.

Kjo Strategji synon:

- Përforcimin e shërbimeve shëndetësore dhe sistemeve ndër-sektoriale për të përmirësuar në mënyrën e duhur reagimin e tyre ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike,
- Inkurajimin e sjelljeve të shëndetshme dhe energji-efektive në të gjitha mjediset dhe dhënia e informacionit dhe mundësisë për ndërhyrje në zbutjen dhe përshtatjen, me një fokus të veçantë në grupet e rrezikuara përmes fushatave të ndërgjegjësimit publik.

Ministria e Bujqësisë me mbështetjen e Bankës Botërore ka hartuar studimin mbi përshtatjen e sistemit bujqësor në Shqipëri ndaj Ndryshimeve Klimatike⁵.

Ministria e mjedisit e mbështetur nga UNDP ka hartuar dokumentin politik për adaptimin e ndryshimeve klimatike në deltata e lumenjeve Drini-Mat dhe me tej.⁶

Gjithashtu, në Planin e Veprimit të Draft-Strategjisë së Zhvillimit të Turizmit 2015-2020, në kuadër të bashkëpunimit të masave për zhvillim të qendrueshëm është parashikuar mbështetja dhe bashkëpunimi, lidhur me nismat për zhvillim të qendrueshëm, si: reduktimi i gjurmës së karbonit energjia dhe ekonomia e gjelbër efikase ekologjike, si dhe organizimi i veprimtarive të përbashkëta në bashkëpunim me aktorët e tjerë si: Ministria e Mjedisit bizneset turistike, donatorët dhe shoqëria civile.

Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Vjenës dhe Protokollin e Montrealit në Tetor të 1999. Në zbatim të detyrimeve që Republika e Shqipërisë ka si Palë e Protokollit të Montrealit, Ministria e Mjedisit në bashkëpunim me agjensitë implementuese Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin Industrial (UNIDO) dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP), hartuan në Gusht 2011, Planin Kombëtar të Heqjes nga Përdorimi të HCFC-ve. Ky plan synon reduktimin në zero të HCFC-ve deri në fund të vitit 2040.

Sfidat për të ardhmen për ndryshimet klimatike:

- (i) përcaktimi dhe zbatimi i objektivave për uljen e shkarkimeve të gazeve me efekt sërre dhe të substancave ozonholluese; ngritja e sistemit të monitorimit, verifikimit dhe raportimit të GHG në linjë me kërkesat e BE-së;
- (ii) Forcimi i kapaciteteve në institucionet përkatëse dhe i bashkëpunimit ndër-institucional për adresimin e çështjeve të ndryshimeve klimatike.
- (iii) Integrimi i ndryshimeve klimatike gjatë planifikimit në strategjitë sektoriale në fushën e shëndetit dhe politikave sociale, bujqësisë dhe pyjeve, biodiversitetit dhe ekosistemeve, zonave bregdetare e detare, ujërave dhe sistemeve të prodhimit;
- (iv) mbështetja ndaj strategjive që përmirësojnë aftësitë ripërtëritëse të shëndetit, pronës dhe funksioneve produktive të ekosistemeve nga ndryshimet e klimes;
- (v) rritja e ndërgjegjësimit publik për adaptim ndaj ndryshimeve klimatike;
- (vi) krijimit të partneriteteve rajonale për të përmirësuar teknologjinë, politikat dhe strategjitë e zbutjes të GHG në të gjithë sektorët.

⁵ Reducing the vulnerability of Albania's agricultural systems to climate change; impact assessment and adaptation options

⁶ Climate Change Adaptation in the Drini Mati River Delta and Beyond-Policy Paper

Ne fushen e kimikateve kuadri ligjor per kimikatet dhe substancat e rrezikshme ekziston, megjithate eshte pjeserisht ne linje me legjislacionin European ne kete fushe. Gjate vitit 2015 eshte parashikuar plotesimi i paketes ligjore per kimikatet, nepermjet miratimit te ligjit te kimikateve dhe 5 akteve nenligjore ne zbatim te tij.

Kontrolli i kimikateve të rrezikshme mbulohet kryesisht nëpërmjet proceduarave te percaktuara nga konventat përkatëse ndërkombëtare te kimikateve: perkatesisht te Roterdamit, Stokholmit dhe Bazelit.

Ndërsa procedura për menaxhimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve, përfshirë bazën ligjore, regjistrimin dhe kontrollin është e kompletuar, ende mbetet punë për të bërë përplotësimin dhe zbatimin e legjislacionit për kimikate të tjerë, si kimikatet industriale, biocidet, kimikatet e konsumit.

Me propozim dhe me kontributin e projektit SAICM-QSP “Forcimi i kapaciteteve për implementimin e SAICM në Shqipëri”, Ministria e Shëndetësisë ka përgatitur së fundmi një draft-ligj për biocidet dhe synon të përafrojë plotësisht Rregulloren Nr.528/2012 te Parlamentit European dhe Keshillit te Europes date 22 Maj 2012, ne lidhje me perdorimin e produkteve te biocidive dhe berjen e vlefshme te tyre ne treg.

Adoptimi i legjislacionit European, kerkon ngritjen e rolit te strukturave shteterore, perfshirjen e organizatave joqeveritare dhe sindikatave te punetoreve qe ne fillim te ndermarrjes se iniciativave ligjore dhe ne veçanti, kur kemi te bejme me kimikate te rrezikshme. Është nevojë e domosdoshme ngritja e nje institucioni koordinues për menaxhimin e kimikateve, siç do te ishte zyra e menaxhimit dhe regjistrimit te kimikateve ne zbatim te detyrave të parashtruara nga ligji Nr 9108 dt 17.7.2003 “Per substancat dhe preparatet kimike”.

Mungojnë kapacitetet e mjaftueshme në institucionet që duhet të mbledhin dhe shpërndajnë informacionin. Për të përmirësuar situatën aktuale mbi menaxhimin e informacionit, është e nevojshme rritja e buxhetit, organizimi i trainimeve dhe rritja e kapaciteteve të strukturave përgjegjëse për informim. Në kuadër të projektit “Forcimi i kapaciteteve për zbatimin e SAICM në Shqipëri është krijuar faqja e internetit www.chemicals.al si mjet për shkëmbimin e informacionit lidhur me menaxhimin e kimikateve.

Në Republikën e Shqipërisë nuk ka akoma një regjistër të kimikateve që të plotësojë kërkesat e legjislacionit Evropian. Nevojitet krijimi i bazave të të dhënave p.sh. për kimikatet e përdorur në industri, për kimikatet e rrezikshme, biocidet, PMB, për planet e emergjencave, etj.

Nuk ka asnje qender informacioni ne vend lidhur me helmimet nga kimikatet, dhe kapacitetet aktuale ne terma praktikë jane te kufizuara, veçanerisht per transportin e viktimave ne rastin e aksidenteve qe perfshijne kimikatet e rrezikshme.

Për disa klasa kimikatesh mungon informacioni i nevojshëm dhe udhëzuesit për masat e sigurisë dhe mbrojtjes nga këto lloj kimikatesh.

Mekanizmat ekzistues punojne te ndare sipas problematikes dhe specifikes se tyre. Ata nuk i mbulojne te gjitha aspektet e rendesishme te kimikateve, te cilat kerkojne nje kooperim dhe

koordinim ndersektorial shumë të mirë. Mungon gjithashtu koordinimi në nivel kombëtar i zbatimit të kërkesave të marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e kimikateve. Është domosdoshmeri krijimi i nje komiteti nder-sektorial per menaxhimin më të mirë të kimikateve.

Nuk ka nje dokument udhezues lidhur me incidentet industriale nga kimikatet e rrezikshme, menaxhimin e incidenteve, toksikologjine ne pergjithesi, metodat e dekontaminimit, perdorimit te antidoteve apo pajisjeve ndihmese gjate ndodhjes se nje emergjence kimike. Rritja e kapaciteteve ne nivel kombetar, rajonal dhe lokal i autoriteteve kompetente per identifikimin dhe vleresimin e raporteve te sigurise se aktiviteteve industriale qe perbejne risk per aksident industrial per shkak te substancave te rrezikshme, perben nje kerkese te domosdoshme.

Qendra Kombetare e Trajnimit duhet te organizoje trajnime ne nivel lokal per parandalimin, gadishmerine dhe pergjigjen ndaj emergjencave kimike per autoritetet kompetente dhe operatoret industriale. Nevojitet gjithashtu rritja e ndergjegjesimit te popullsise mbi rrezikun e aksidenteve industriale.

Ka nje nevoje urgjente per ngritjen e nje task force/komiteti për zbatimin e Rregulloreve Ndërkombëtare të Shëndetit (2005) me perfaqesues nga te gjitha Ministrite dhe sektoret perkates ne Shqiperi e cila duhet te jete e lidhur me Piken Kombetare te Kontaktit (PKK) prane Institutit te Shendetit Publik. Ky komitet duhet te planifikoje, vereje dhe monitoroje zbatimin e RNSH (2005), përfshirë edhe problematikën përkatëse lidhur me kimikatet.

Infrastruktura laboratorike është në mjaft raste e vjetëruar dhe jo bashkëkohore. etj. Nuk është vendosur ende në të gjithë laboratorët sistem i brendshëm i cilësisë, dhe vetem një numër i kufizuar laboratorësh janë akredituar. Mungojnë procedurat për menaxhimin e kimikateve dhe materialeve të rrezikshëm si dhe për eliminimin e mbetjeve të tyre.

Ndërgjegjësimi për rrezikun ndaj kimikateve në të gjitha grupmoshat si dhe në të gjitha nivelet është ende i ulët. Ndërgjegjësimi si dhe trajnimi i grupeve të ndryshme të profesionistëve, si fermerëve, transportuesve, industrialistëve, stafit teknik, si edhe i konsumatorit, për sigurinë në përdorimin e kimikateve, është një hap i rëndësishëm për uljen e këtij rreziku.

Në kuadër të nevojës për forcimin e kapaciteteve mbi menaxhimin e kimikateve në vend nevojitet të ngrihen programe të mirëfillta trajnimesh për inspektorët dhe stafet profesionale, të cilat të jenë të qëndrueshëm dhe metodologjikisht të konsoliduara si në trajtën e programeve të plotë për formimin e kuadrit të ri, ashtu edhe programe të shkurtër rifreskues.

Është i nevojshëm përmirësimi i kushteve të përdorimit të kimikateve për shëndetin publik, nevojiten më shumë fonde për blerjen e lëndëve biocide, si edhe të materialeve manipuluese, veshjeve mbrojtëse të punonjësve etj. Shumë i nevojshëm është edhe trajnimi i stafeve që kryejnë trajtimet me biocide.

Nevojitet një projekt i përbashkët midis MSh, ISHP dhe Bashkive, i cili të jetë efikas për një program të kontrollit të integruar të dëmtuesve (pesteve) në shëndet publik. Po kështu duhet promovuar edhe menaxhimi i integruar i dëmtuesve të kulturave bujqësore.

Mbetet ende problem mbledhja dhe shpërndarja e informacionit për sasi të dhe llojet e mbetjeve

industriale të reja që gjenerohen nga aktiviteti i subjekteve industriale të licensuara pas vitit 1992.

MM ka bërë një punë të mirë për identifikimin, prioritizimin dhe studimin e vatrave të ndotura mjedisore. Vatra më problematike e Porto-Romanos dhe vatra të tjera të ndotura janë pastruar me ndihmën e UNDP dhe me kontributin e Qeverisë së Hollandës. Në vazhdim të përpjekjeve të MM për identifikimin dhe pastrimin edhe të vatrave të tjera problematike, është bërë edhe një studim paraprak i 35 pikave të nxehta mjedisore në Shqipëri dhe është bërë studimi i thelluar për 14 vatra ndotjeje industriale të trashëguar me qëllim rehabilitimin e pastrimin e tyre.

Përgjegjësia për ndotjen është një çështje e rëndësishme në pastrimin e zonave të ndotura dhe privatizimit të tyre. Nuk ka një legjislacion specifik për përgjegjësinë për ndotjen industriale të mëparshme dhe nuk është e qartë se kush duhet të paguajë.

Nevojitet hartimi dhe zbatimi i një plani kombëtar veprimi për menaxhimin e kimikateve, çka do mundësojë plotësimin e mangësive të shumta të identifikuara gjatë rishikimit të Profilit Kombëtar.

Sfidat për të ardhmen perfshijne ngritjen e sistemit kombëtar të menaxhimit të kimikateve në përputhje me rregulloret e BE, Konventen e Roterdamit, Konventen e Stokholmit, Konventen e Bazelit dhe Sistemin Global të Harmonizuar (GHS) nepermjet (i) përafrimit të legjislacionit kombëtar me atë komunitar në fushën e kimikateve (ii) përmirësimit të koordinimit ndër-institucional për zbatimin e legjislacionit (ii) Ngritja e Zyres së Menaxhimit të Kimikateve (iii) hartimi të planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e kimikateve duke synuar parandalimin e ndotjes së mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit human.

Mbetjet. Menaxhimi i mbetjeve në vend është akoma në një nivel të ulët. Me sisteme për grumbullimin e mbetjeve të ngurta janë pajisur vetëm qytetet, por jo zonat rurale. Sasia e mbetjeve që riciklohet, është në masën 10%. Kryesisht mbetjet asgjësohen në vend grumbullimit të mbetjeve. Përveç landfilleve të Sharres dhe Bushatit ka përfunduar ndërtimi i landfillit në Sarandë/Bajkaj ndërsa brenda një afati të shkurtër (2015) do të fillojë ndërtimi i landfillit në Korçë/ Maliq (mbështetur nga KfW).

Nuk ka një sistem të sigurtë për administrimin e mbetjeve të rrezikshme (atyre të prodhuara nga industritë dhe ato shtëpiake). Sistemi i menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme është shumë i dobët dhe pjesa më e madhe e grumbullimit të mbetjeve kryhet nga sektori privat, gjithashtu edhe impiantet e riciklimit janë në pronësi të sektorit privat.

Ndërgjegjësimi i publikut për menaxhimin e mbetjeve është në nivele të ulëta.

Një sasi e konsiderueshme mbetjesh qarkullojnë në rrjetin hidrik duke krijuar një stres potencial ndotes, duke ndikuar kështu veçanërisht në degradimin e zonave të mbrojtura bregdetare dhe ulur kështu aftësinë e tyre ripërteritese në këto zona të ndjeshme ndaj ndryshimeve të klimes.

Politika e programit të menaxhimit të mbetjeve synon menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve dhe mbrojtjen e mjedisit nepermjet transpozimit dhe zbatimit të kërkesave të direktivave të BE në fushën e menaxhimit të mbetjeve, zbatimit të Strategjisë dhe Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve si dhe hartimit dhe zbatimit të planeve të veprimit të menaxhimit të mbetjeve në nivel

rajonale dhe lokale.

Hapa të rëndësishme janë hedhur në fushën e përafërimit të legjislacionit të BE në fushën e mbetjeve:

- VKM 175, datë 19.01.2011 “ Për miratimin e Strategjisë dhe Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve “.
 - Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011 “ Për menaxhimin e integruar të mbetjeve “.
 - Vendim nr. 705, datë 10.10.2012 “ Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës”
 - Vendim nr. 177, datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”.
 - Vendim nr. 178, datë 6.3.2012 “ Për incinerimin e mbetjeve”.
 - Vendim nr. 452, datë 11.7.2012 “Për lëndfillet e mbetjeve”.
 - Vendim nr. 765, datë 7.11.2012 “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura”.
 - Vendim nr. 866, datë 4.12.2012 “Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre”.
 - Vendim nr.957, datë 19.12.2012“Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike”.
 - Vendim nr.117, datë 13.02.2013 “Për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje”.
 - Ligji nr.156, datë 10.10.2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.
 - Vendim nr. 52 datë 5.2.2014 “Për disa ndryshime në vendimin nr.117, datë 13.2.2013 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret që përcaktojnë kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje”.
 - Vendim nr. 798, datë 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”.
 - Vendim nr. 229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”.
 - Vendim nr.371, datë 11.06.2014 “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”.
 - Vendim nr.418, datë 25.06.2014 ” Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”.
 - Vendim nr.608, datë 17.09.2014 ” Për përcaktimin e masave të nevojshme për nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre”.
 - Vendim nr. 641, datë 01.10.2014 “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte”.
- Sfidat në fushën e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve janë: (i) ngritja dhe funksionimi i Sistemit të Integruar të menaxhimit të mbetjeve; (ii) ndërgjegjësimi i komunitetit për trajtimin e mbetjeve; si dhe (iii) bashkërendimi administrativ ndërmjet strukturave qendrore dhe vendore për zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe qartësimin funksional të tyre.

Në fushën e mbrojtjes së natyrës është realizuar transpozimi i Direktivave kryesore të kësaj fushe, respektivisht Direktivës së Habitave dhe Direktivës së Shpendëve, duke arritur në një masë transpozimi mbi **85 %** për këto Direktiva.

Është plotësuar kuadri ligjor kombëtar nëpërmjet janë hartimit dhe miratimit prej vitit 2006 të

një numër ligjesh të rëndësishme në fushën e mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit që transpozojnë direktivat e sipërpërmendura si: Ligji “Për mbrojtjen e faunës së egër”, Ligji “Për gjuetinë”, Amendimi i Ligjit “Per zonat e Mbrojtura”, Ligji “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave te tregëtimit nderkombetar te llojeve te rrezikuara te faunes dhe flores se eger”, amendimi i Ligjit “Për biodiversitetin” si dhe nje numer aktesh nenligjore ne zbatim te tyre.

Ruajtja dhe rritja e larmisë biologjike është synuar përmes rritjes së sipërfaqes së zonave të mbrojtura nga 10,4 % ose 303 mijë ha të territorit të vendit në vitin 2007 në **16,61 %** ose **477** mije hektare në fund të vitit **2014**(*) nëpërmjet shpalljes së Zonave të reja të Mbrojtura si dhe zgjerimit të atyre ekzistuese duke kontribuar në sigurimin e statusit të favorshëm të ruajtjes duke siguruar ruajtjen dhe mbijetesën e llojeve.

Tabela e rrjetit aktual dhe harta e Zonave të Mbrojtura është dhënë në Aneksin bashkëlidhur. Është realizuar përgatitja e Planeve të Menaxhimi për 10 Zona të Mbrojtura dhe është në përfundim procesi i përgatitjes për 10 Zona të Mbrojtura të tjera.

Është realizuar zbatimi në praktike i planeve të menaxhimit të miratuara dhe ndërtimi e forcimi i kapaciteteve të administratave të zonave të mbrojtura, kryesisht në ato zona të mbrojtura në të cilat zbatohen projekte të donatorëve si: Liqeni i Shkodrës, Parku Kombëtar Prespë, Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta, Parku Kombëtar Detar Sazan-Karaburun etj. Gjithashtu është miratuar metodika standarte për hartimin e planeve të menaxhimit të zonave të mbrojtura.

Sfidat për të ardhmen përfshijnë përgatitjen për identifikimin dhe ngritjen e rrjetit Natura 2000 të zonave të veçanta të ruajtjes me rëndësi për komunitetin evropian. Zbatimi i planeve të menaxhimit për ato Zona të Mbrojtura që kanë plane të miratuara. Forcimi i zbatimit të ligjit dhe ngritja e kapaciteteve administrative të stafit të administratave të zonave të mbrojtura dhe organeve të kontrollit për ruajtjen e florës dhe faunës së egër përbëjnë prioritet.

Në fillim të vitit 2015 u miratua krijimi i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura. Me këtë organizim dhe funksionim është arritur që për herë të parë në Shqipëri të ketë një strukturë të veçantë dhe të shkëputur nga DSHP për Zonat e Mbrojtura që synon të sigurojë një menaxhim të pavarur të tyre. Administratat e zonave të mbrojtura me krijimin e AKZM do të kenë një lidhje të drejtpërdrejtë me Ministrinë e Mjedisit, si një agjenci e pavarur dhe e dedikuar në mbrojtjen e natyrës. Krijimi i kësaj agjencie krijon premisa për akses me të lehtë dhe vizibilitet të administrative të zonave të mbrojtura, duke mundësuar aplikimin e drejtpërdrejtë dhe menaxhimin direkt të fondeve nga ky institucion.

Një nga objektivat e realizuara të politikës **ne sektorin pyjor**, nëpërmjet programeve të realizuara është arritur transferimi i pyjeve dhe kullotave drejt 315 njësive të qeverisjes vendore për të siguruar gjithë përfshirjen duke i mbështetur ato me plane menaxhimi dhe punime pyllëzimi dhe përmirësimi në pyje. Sipërfaqja e pyjeve kullorosor e mbuluar me plane mbarështimi deri në vitin 2012, është rritur me 48% krahasuar me vitin 2007 nga punimet pyjore të kryera në 12.000 ha pyje të degraduar, erozioni është reduktuar me rreth 200.000 ton sedimente.

Për parandalimin e aktivitetëve të paligjshme nga ana e strukturave të Policisë Pyjore me masat e marra janë ulur niveli i prerjeve të paligjshme në pyje, nga 8% në vitin 2007 në 55 % në vitin 2011. Sipërfaqe të konsiderueshme të pyjeve aluvionale bregdetare po eliminohen çdo vit si rezultat i erozionit bregdetar i cili është mjaft aktiv.

Sfidat për të ardhmen. Objektivat e ardhshëm do të jënë: (i) përafrimin dhe zbatimin e legjislacionit europian në fushën e pyjeve dhe kullotave; (ii) rritja e kapaciteteve të menaxhimit të pyjeve komunale nëpërmjet grave konkurruese dhe forcimit të kapaciteteve; (iii) përmirësimi i sistemit të informacionit dhe data bazës pyjore; (iv) forcimi i sistemit të kërkimit, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit në pyje; (v) përmirësimi i marrëdhënieve rajonale, aplikime të përbashkëta në programe ndërkombëtare dhe unifikimin e teknologjive e metodologjive; (vi) aplikimi në programe kombëtare e ndërkombëtare për të siguruar një mbështetje të nevojshme për zhvillimin e pylltarisë në vend, dhe (viii) përfshirja e çështjeve të ndryshimeve klimatike në të gjithë aspektet e administrimit të menaxhimit të fondit pyjor.

Ne fushën e **administrimit të burimeve ujore**

Ka përfunduar hartimi i Planit të menaxhimit të basenit të lumit Mat, i cili përfshin edhe çështjet që lidhen me ndikimin e ndryshimeve klimatike dhe adaptimin, gjithashtu është miratuar VKM Nr. 643, datë 14.09.2011 “Për miratimin e Strategjise Kombëtare Sektoriale të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, për Ujesjelles-Kanalizimet”. Është firmosur një Memorandum Mirekuptimi “Për Realizimin e masave për rregullimin e regjimit ujor të pellgut ujëmbledhës të liqenit të Shkodrës, lumit të Bunës dhe Drinit” si dhe është firmosur Memorandumi i Mirekuptimit për Drinin: “Një vizion i përbashkët strategjik”, midis Shqipërisë dhe vendeve fqinje. Menaxhimi i baseneve ujëmbledhës në përputhje me planet e menaxhimit të tyre ka një rritje prej 17% krahasuar me vitin 2007. Nga monitorimi i ujerave rezulton se përqindja e rasteve të përputhjes së treguesve të cilësive të ujerave; NBO5, NH4, O2 i tretur, NO3, P-total, me standartet europiane të cilësive të ujerave, është rritur me 8% në krahasim me vitin 2007.

Sfidat për të ardhmen (i) Përmirësimi dhe forcimi i zbatimit të legjislacionit (ii) Forcimi i autoriteteve përgjegjëse në nivel qendror dhe lokal (iii) Hartimi i planeve të menaxhimit të të gjithë baseneve të lumenjve si dhe krijimi i kadastrës ujore elektronike; (iv) Hartimi i Strategjise Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Ujerave; (v) përfshirja e çështjeve të ndryshimeve klimatike në të gjithë dokumentet strategjike të administrimit të ujerave.

Kapitulli 2: Vizioni Politik dhe Qellimet e Politikave

Vizioni

Vend me një zhvillim të qëndrueshëm social dhe ekonomik, duke mbrojtur burimet natyrore nga ndotja dhe degradimi, nëpërmjet menaxhimit të integruar të tyre dhe duke promovuar vlerat mjedisore e duke i vendosur ato në përfitim të prosperitetit ekonomik.

Ky vizion mbështetet në parimin e zhvillimit të integruar ku mbrojtja dhe përmirësimi i gjendjes së medimeve mjedisore garanton sigurinë e rritjes ekonomike dhe mirqënien sociale.

Politikat e mbrojtjes së mjedisit

Politikat mjedisore gjatë periudhës 2015 -2020 do të fokusohen në menaxhimin qëndrueshëm të mjedisit nëpërmjet:

- përmirësimi të cilësive dhe reduktimi i ndotjes së ajrit dhe ndotjes akustike në zonat

kryesore urbane dhe zonat turistike;

- parandalimit dhe kontrollit të integruar të ndotjes dhe rreziqeve nga ndotja dhe aksidentet industriale duke monitoruar dhe kontrolluar zbatimin e normave dhe standarteve të shkarkimeve në mjedis nga operatorët industriale;
- kryerjes së Vlersimeve të Ndikimit të Mjedisit për projektet e zhvillimit, me qëllim që Autoriteti i planifikimit ose autoriteti përgjegjës për licencimin, kur shqyrton dhënien ose jo të lejes së zhvillimit/licencës përkatëse për një projekt, apo vendosjen e kushteve për zhvilluesin, marrë në konsideratë perfundimet e procesit të Vleresimit të Ndikimeve mjedisore për ndikimet në mjedis që do të ketë projekti i propozuar, si dhe perfshirjen e publikut dhe të gjithë aktoreve gjatë procedurës së Vleresimit të ndikimit në mjedis.
- kryerjes së Vlersimeve Strategjike Mjedisore për planet apo programet, për vleresimin e pasojave në mjedis të një plani ose programi të propozuar për zbatim, me qëllim që të sigurojë që këto pasoja mjedisore të adresohen plotësisht që në fazat e hershme të vendimmarrjes përkrah konsideratave ekonomike dhe sociale.
- menaxhimin e integruar të mbetjeve me fokus në përmbushjen e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare, trajtimin e mbetjeve brenda këtyre standardeve dhe rritjen e ndërgjegjes sociale mbi efektet e dëmshme të mbetjeve në mjedis.
- ngritjes së Sistemit Kombëtar të Menaxhimit të Kimikateve;
- mbrojtjes dhe menaxhimit të qëndrueshëm të biodiversitetit, shtimit të sipërfaqes së Zonave të Mbrojtura, menaxhimin e integruar të tyre dhe ngritjen e rrjetit ekologjik "NATURA 2000";
- mirë menaxhimin e burimeve ujore nepermjet vendosjes së një kuadri monitorimi dhe kontrolli, për të reduktuar ndotjen e ujerave nentokesore dhe sipërfaqesore nga aktivitetet e veprimtarive industriale, bujqesore dhe aktivitetet e popullsisë në zonat rurale dhe urbane, që shkaktojnë dëmtim të ekosistemeve ujore, si dhe të lumenjve nga shfrytëzimi pa kriter, mbrojtja e ujerave detare, menaxhimi i ujerave ndërkufitare, zvogëlimi i efekteve nga permbytja dhe thatësira;
- menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve të gjalla të ujerave detare dhe të ujerave të brendshme;
- zhvillimin e qëndrueshëm dhe shumë funksional të burimeve pyjore dhe kullimore që sigurojnë shtimin e sipërfaqeve pyjore rrisin prodhimtarinë dhe aftësinë ripërtëritëse të pyjeve, parandalojnë degradimin e mëtejshëm të tokës, mbrojnë biodiversitetin e sigurojnë potencial maksimal për të përmbushur funksionet ekologjike, ekonomike dhe sociale në nivel lokal, kombëtar dhe global pa cenuar ekosisteme të tjera.

Politikat e ndryshimeve klimatike gjatë periudhës 2015 -2020 përfshijne:

- Forcimin e kapaciteteve në institucionet përkatëse për hartimin e politikave për klimën, me prioritet ngritjen e sistemit të monitorimit dhe të raportimit vjetor të GHG-ve në përputhje me kërkesat e BE-së dhe përcaktimin e pikave fokale për ndryshimet klimatike në ministritë dhe agjencitë përkatëse;

- Percaktimin e skenarëve të përmirësuar të emisioneve të gazeve me efekt serrë në kuadër të Komunikimit të Tretë Kombëtar në bazë të informacionit të ri nga inventari i pyjeve për vitin 2014 dhe Inventaritet të GHG deri në vitin 2010;
- Percaktimin në qershor 2015, të kontributit kombëtar për reduktim të GHG deri në vitin 2020, në kuadër të arritjes së marrëveshjes së madhe të paleve në Paris 2015.
- Zhvillimin e NAMA-ve prioritare me përfitime ekonomike, sociale dhe mjedisore të cilat mund të marrin mbështetje nga donatorët (shumëpalëshe dhe dypalëshe), dhe në mënyrë të veçantë nga Fondi i Gjellbër i Klimës.
- Vendosjen e një mekanizmi efektiv dhe efikas të financimit për të kanalizuar fondet e brendshme dhe ndërkombëtare të lidhura me veprimet për klimën;
- Zbatimin e Planit të Veprimit për Eficiencën e Energjisë;
- Integrimi i objektivave të përshtatjes (adaptimit) dhe reduktimit të GHG në planifikimin urban, menaxhimin e ujërave dhe tokës duke përfshirë bujqësinë, pyjet dhe ruajtjen e natyrës.
- Mbështetjen e strategjive që përmirësojnë aftësitë ripërteritese të shëndetit, pronës dhe funksioneve produktive të ekosistemeve ndaj ndryshimeve të klimës;
- Krijimin e partneritetit rajonal për përmirësimin e teknologjisë, politikave dhe strategjive për mitigim në të gjitha sektorët e ekonomisë.

Qellimet e politikave

Objektivat që synohen të arrihen gjatë kësaj periudhe të mbështetura edhe në politikat ndërsektoriale të mbrojtjes së mjedisit dhe ndryshimeve klimatike janë:

- **Në fushën e cilësisë së ajrit:** (i) ulja me 40% e nivelit të ndotjes në zonat urbane; (ii) arritja e niveleve të ndotësve të ajrit, bazuar në shëndetin human, në vlerat përkatëse: për NO_x - 40 μ/ m³, për PM₁₀ - 40 μ/ m³, për PM_{2,5-25} μg/m³ dhe 20 μg/m³ dhe SO₂-125 μ/ m³ për 24 ore ose 20 μ/ m³ në vit.
- **Në fushën e Ndryshimeve Klimatike dhe mbrojtjes së shtresës së Ozonit:** (i) reduktimi me 8% të GHG krahasuar me skenarin bazë⁷; (ii) reduktimi i sasisë së HCFC-ve me 40%;
- **Në fushën e mbrojtjes së natyrës:** (i) Rritja e sipërfaqes së Zonave të Mbrojtura në 17 % të territorit nëpërmjet zgjerimit dhe menaxhimit të integruar të Zonave të Mbrojtura; (ii) Ngritja e rrethit ekologjik “NATURA 2000”; (iii) Sigurimi i statusit të ruajtjes për 5 % të llojeve dhe habitateve të kërcënuara;
- Po në fushën e mbrojtjes së natyrës deri në vitin 2020 synohet rritja e sipërfaqes së Zonave të Mbrojtura në 17 % të territorit tokësor të vendit dhe shpallja e ZM-ve të reja detare dhe bregdetare; identifikimi dhe ngritja e rrethit Natura 2000 dhe ruajtja e peizazhit natyror; përmirësimi i statusit të ruajtjes për 5 % të llojeve dhe habitateve të kërcënuara të mbrojtura deri në fund të kësaj dekade si dekada e Kombeve të Bashkuara për biodiversitetin 2011-2020.
- **Në fushën e burimeve pyjore dhe kullosore:** ulja me 40% të prerjeve të paligjshmeve të fondit pyjor (ii) Mbulimi 100% me plane mbarështrimi për të gjitha ekonomitë pyjore në nivelkombëtar, ; (iii)Rehabilitimi i sipërfaqeve të degraduara në

⁷ Projektionet e tanishme të emisioneve GHG për 2020 tregojnë vlerën 18,000 Gg CO₂ eq. Ky projektion do të rishikohet gjatë 2014/2015 në kuadër të Komunikimit të tretë Kombëtar të UNFCCC. Në rast të angazhimit të fondeve ndërkombëtare për NAMAs, (Masat Kombëtare përkatëse për Reduktimit të GHG), reduktimi i GHG mund të rritet me 16% krahasuar me skenarin bazë.

- masën 25 %;
- **Ne fushen e ujerave:** (i) inventarizimi i 100% të burimeve ujore dhe ngritja e e Kadastrës Kombëtare të Ujërave; (ii) Arritja e niveleve të cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, në vlerat përkatëse, për NBO5 2-10 mg/l, për NH4 0.05 mg/l, P-total 0.1 mg/l⁸; (iii) Rehabilitimi i shtretërve të dëmtuar të lumenjeve me 25 % deri në vitin 2020;
 - **Ne fushen e menaxhimit te integruar te mbetjeve:** (i) Rritja e sasisë së mbetjeve që shkojnë në landfill në masën 45% ; (ii) riciklimi dhe kompostimi i mbetjeve urbane në masën 55 %; (iii) zbatimi i planeve të rehabilitimit për 9 hotspotet prioritare dhe hartimi i planeve për hotspotet e mbetura.
 - **Ne fushen e zhurmave:** Reduktimi i ndotjes akustike me 30% në zonat kryesore urbane, krahasuar me vitin 2014 (vlerat mesatare të zhurmës gjatë periudhës së ditës të reduktohen nga 70 dB (A) në 56 dB (A) dhe vlerat mesatare të zhurmës gjatë periudhës së natës të reduktohen nga 55 dB (A) në 45 dB(A).
 - **Ne fushen e kimikateve:** Funksionimi i sistemit kombëtar të menaxhimit të kimikateve në përputhje me rregulloret e BE-së, Konventën e Roterdamit dhe Sistemin Global të Harmonizuar (GHS); Arritja në 100% e përputhshmërisë së kuadrit normativ me rregulloret e BE në fushen e kimikateve deri në vitin 2020.
 - Garantimi i përputhshmërisë së plote të operatoreve të medhenj industrialë, me normat e shkarkimeve në ajër (PM10, SO2, NOx) dhe ujë sipas kërkesave të ligjit “Për lejet mjedisore” dhe standarteve të përcaktuara në direktivat IPPC dhe LCP, krahasuar me vitin 2013.
 - **Ne fushen e mbrojtjes së natyres deri në vitin 2020** synohet rritja e sipërfaqes së Zonave të Mbrojtura në 17 % të territorit tokësor të vendit dhe shpallja e ZM-ve të reja detare dhe bregdetare dhe ruajtja e peizazhit, përmirësimi i statusit të ruajtjes për 5 % të llojeve dhe habitateve të kërcënuara të mbrojtura deri në fund të kesaj dekade si dekada e Kombeve të Bashkuara për biodiversitetin 2011-2020.
 - **Ne fushën e pyjeve dhe kullotave,** synohet menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve pyjore dhe kullimore, gjithpërfshirja e aktorve lokale në menaxhimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të këtij sektori, vendosja e skemave për pagesa në ekosistem, forcimi institucional dhe ligjor.
 - Përmirësimi i organizimit e procesit të prodhimit pyjor për pyjet e lartë, me objektiv formimin e njësive të reja territoriale të prodhimit për pyjet e lartë prodhues.
 - Realizimit i planeve të mbarështimit për 10 njësi të tilla prodhuese dhe të gjithësipërfaqen e fondit pyjor dhe kullor prej 1 700 000 ha, azhurnimi i Kadastrës Kombëtare të Pyjeve dhe Kullotave,
 - Rehabilitimi nëpërmjet pyllëzimit dhe ripyllëzimit të sipërfaqeve të djegura si dhe rehabilitimin e kullotave me mbjellje foragjere e drusore në masën deri 15 % të sipërfaqes pyjore dhe kullimore deri në vitin 2020.
 - Parandalimit të gërryerjes së mëtejshme të tokës pyjore dhe kullimore në 25 % të sipërfaqes, deri në vitin 2020.
 - Brenda vitit 2020 në legjislacionin kombëtar të arrihet transpozimi i plote i plote (100 %) i legjislacionit evropian, në fushën e pyjeve krahasuar me 50 % në vitin 2011; Sigurimi i kuadrit rregullator, institucional dhe ekonomik për zbatimin e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve.
 - Sigurimi i të drejtave tradicionale të përdorimit/pronësisë mbi pyjet, duke

⁸ Vlerat e dhena janë Standarte të Cilësisë së Ujërave Siperfaqësore nga Direktiva Kuader e Ujit e BE-se, 2000/60/EC..

vendosur mekanizma për reduktimin e prerjeve ilegale dhe tregtimit të lëndës drusore, në masën 100 % si dhe parandalimi i zjarreve në masën 80 % të sipërfaqes së rrezikuar, krahasuar me 50 % si dhe parandalimi i zjarreve në masën 37 % të sipërfaqes së rrezikuar në vitin 2011.

- Rritja e efektivitetit ekonomik dhe e eficiencës energjetike nga përdorimi i qëndrueshëm i pyjeve shtetërore, rritjen e sipërfaqes pyjore nëpërmjet pyllëzimit dhe ripyllëzimit me arvore të pyjeve në masën 15% të sipërfaqes me bimësi pyjore dhe djerr, ngritja e një fidashte pyjore për sigurimin e 4000000 fidanëve arvore të pyjeve për mbjellje. Kryerja e punimeve silvikulturore për përmirësimin e grumbujve pyjor me ndërhyrje ripërtëritëse për 30000 ha pyje.
- Përmirësim kullotash duke realizuar deri 80% të sipërfaqes së planifikuar. Forcimi i kapaciteteve për menaxhimin e qëndrueshëm dhe shumë funksional të fondit pyjor dhe kullor në masën 100%. Vendosja deri në vitin 2020 të sistemit të shërbimeve në ekosistem dhe adaptimi kundrejt ndryshimeve klimatike në masën 100%.
- Realizimi i data bazën pyjore (GIS), hartimi dhe miratimi i planeve mbarështimit për 100% të fondit pyjor dhe kullor krahasuar me vitin 2011 që është 50%, azhurnimi i të dhënave të tyre duke realizuar 100% të objektivit si dhe krijimi i njësive territoriale me funksion prodhues dhe menaxhimi i integruar i tyre nëpërmjet teknikave të avancuara. Forcimi i sistemit të kërkimit, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit në pyje.
- Vendosja e marrëdhënieve rajonale e me gjere, për shkëmbimin eksperiencave, aplikime të përbashkëta në programe ndërkombëtare dhe unifikimin e teknologjive e metodologjive në masën 80%. Sigurimi i mekanizmave financiare për të përmirësuar statusin e pyjeve dhe zhvillimin e sektorit të pyjeve. Vazhdimin e procesit permbylles të transferimit të pyjeve dhe kullotave tek organet e qeverisjes vendore drejt kalimit tek komunitetet të drejtave të plota mbi përdorimin (uzufrukt), procesi i cili rrit rolin e pushtetit vendor në planifikimin dhe menaxhimin e burimeve natyrore pyjore e kullorore”. Dhenia e asistencës teknike dhe ligjore nëpërmjet shërbimit këshillimor për ngritjen e strukturave menaxhuese të pyjeve dhe kullotave në komune (250 komuna). Perfundimi i procesit të regjistrimit të pyjeve komunale në AKKP.

Kapitulli 3: Objektivat e politikës dhe produktet madhore **Objektivat afatmesme (2015-2017)**

Mbrojtja e mjedisit:

1. Në fushën e cilësisë së ajrit: Të reduktohen nivelet e NOx me 8%, të PM10 me 20%, të PM2,5 me 12% krahasuar me nivelet e vitit 2013 përkatësisht: për NOx - 40 µ/ m³, për PM10 - 83 µ/ m³, të PM2,5-33 µ/ m³ dhe të ruhen nivelet e vitit 2013 për SO2 me 8 µ/ m³.

Produktet

- Zbatueshmëria e legjislacionit për kontrollin teknik të automjeteve të përmirësuar
- Plan Kombëtar i cilesisë së ajrit të mjedisit të hartuar
- Forcimi i zbatimit të legjislacionit për cilesinë e lëndës djegëse dhe krijimi të bazës së të dhënave nga AKM për cilesinë e lëndës djegëse
- Inspektime kontrolli në aktivitetet industriale që shkaktojnë shkarkime në ajër
- Inventari kombëtar i shkarkimeve të ndotesve në ajër të hartuar dhe përditësuar mbi baza vjetore.

- Procedurat Standarte te Operimit për monitorimin e ajrit te miratuara.
- Arritja e transpozimit (80 %) te legjislacionit europian ne fushen e ajrit krahasuar me 21 % ne vitin 2013;

2. Ne fushen e zhurmave: Te reduktohet ndotja akustike me 10% ne zonat kryesore urbane, krahasuar me vitin 2012 (vlerat mesatare të zhurmës gjatë periudhës së ditës te reduktohen nga 70 dB (A) ne 65 dB dhe vlerat mesatare të zhurmës gjatë periudhës së natës te reduktohen nga 55 dB (A) ne 52 dB(A).

Produktet

- Hartimi i planeve lokale te zhurmave ne mjedis
- Pergatitja e hartes kombetare te zhurmave
- Vleresimi i zonave me kerkesa strikte ndaj zhurmave (Spitale, Shkolla, Azile, Kopshte, Çerdhe etj), dhe propozimi i masave perkatese per minimizimin e zhurmave
- Pajisja me leje mjedisi e aktiviteteteve te sherbimit social dhe monitorimi i zbatimit te kushteve te lejes nga IM.
- Forcimi i zbatimit te legjislacionit per zhurmat
- Brenda viti 2015 te filloje procesi i rishqyrtimit te lejeve mjedisore te integruara te tipit A dhe brenda viti 2016 te kryhet miratimi i planeve te perputhshmerise per 100% te operatoreve industriale.

3. Ne fushen e kimikateve: Ngritja e sistemit kombëtar të menaxhimit të kimikateve në përputhje me rregulloret e BE-së, Konventën e Roterdamit dhe Sistemin Global të Harmonizuar (GHS); Arritja ne 70% e perputhshmerise se kuadrit normativ me rregulloret e BE ne fushen e kimikateve deri ne vitin 2020

Produktet

Akte ligjore ne fushen e kimikateve te hartuara:

- Ligji “Mbi kimikatet” qe transponon Rregulloren (EC) Nr 1907/2006 per Regjistrimin, Vleresimin, Autorizimin dhe Kufizimin e Kimikateve (REACH)
- VKM “Mbi klasifikimin, paketimin dhe etiketimin e kimikateve” qe transponon Rregulloren 1272/2008 “Mbi klasifikimin, etiketimin, paketimin e substancave dhe perzjerjeve”;
- VKM per importin dhe eksportin e kimikateve qe transponon Rregulloren e Këshillit dhe të Parlamentit Europian (EC) Nr. 689/2008, e datës 17 Qershor 2008, për “Importin dhe eksportin e kimikateve të rrezikëshme”;
- VKM “ Mbi ndalimin dhe kufizimin e prodhimit, hedhjes në treg dhe përdorimit të kimikateve te rrezikeshme”, qe transponon Aneksin XVII “Për Ndalimin dhe kufizimin e prodhimit, hedhjes në treg dhe përdorimit të substancave të cilat përbëjnë një rrezik të papranueshëm për shëndetin e njeriut dhe mjedisin”, i Rregullores nr. 1907/2006 të Këshillit të Europës, datë 18 Dhjetor 2006, mbi Regjistrimin, Vlerësimin, Autorizimin dhe Kufizimin e Kimikateve (REACH).
- VKM “Për miratimin e listes se substancave të rrezikshme, që prej natyrës së tyre, përbëjnë një rrezik serioz për jetën, shëndetin e njeriut dhe mjedisin”

- Miratimi i ligjit për produktet dhe shërbimet biocide;
- Përgatitja e akteve nenligjore që rrjedhin nga ligji për produktet dhe shërbimet biocide;
- Plani kombëtar për menaxhimin e kimikateve i hartuar;
- Zyra e menaxhimit të kimikateve e krijuar;
- Ngritja e një taskforce/komiteti për zbatimin e Rregulloreve Ndërkombëtare të Shëndetit;
- Komiteti nder-sektorial për menaxhimin më të mirë të kimikateve i krijuar dhe funksional.
- Ngritja e strukturave zbatuese të procesit të autorizimit të produkteve biocide;
- Përgatitja e programeve të trajnimit dhe trajnim i inspektorëve lidhur me kërkesat ligjore të legjislacionit të produkteve dhe shërbimeve biocide dhe zbatimin e tij;
- Krijimi i një shërbimi informacioni për helmimet 24/24 pranë Shërbimit të Adiktologjisë, QSUT.

Në fushën e Ndryshimeve Klimatike dhe mbrojtjes së shtresës së Ozonit:

- (i) reduktimi me 8% të GHG krahasuar me skenarin bazë⁹;
- (ii) reduktimi i sasisë së HCFC-ve me 40%;

Reduktimi i emetimeve të gazeve me efekt sërre me 4% në vitin 2017, në krahasim me skenarin bazë dhe reduktimi i nivelit të substancave që hollojnë shtresën e ozonit, hidrofluorocarboneve (HCFC), me 10% në vitin 2015, në krahasim me vitin 2011:

Produktet:

- Hartimi i Komunikimit të Tretë Kombëtar të UNFCCC-se në bazë të informacionit të ri që do të merret në vitin 2014 nga inventari i ri i pyjeve dhe Inventari i GHG-ve deri në vitin 2010;
- Miratimi i Strategjisë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike brenda vitit 2015 duke përfshirë edhe kontributet e zbutjes të përcaktuara në nivel kombëtar në kuader të marrëveshjes ndërkombëtare të pas 2020 nën UNFCCC.
- Zbatimi i kërkesave të Traktatit të Komunitetit të Energjisë të ratifikuar nga Kuvendi duke përfshirë Planin e Veprimit për Eficencën e Energjisë
- Zbatimi i kërkesave të legjislacionit për energji të rinovueshme dhe eficienten e energjisë
- Miratimi i instrumentit financiar për zbatimin e Planit të Veprimit për Efiçencën e Energjisë dhe masat e tjera në lidhje me klimën (Eco Fund)
- Hartimi i programit për reduktimin e emisioneve të GHG-ve në Industrinë e Çimentos
- Arritja e përputhshmërinë në shkallën 55% të kornizës normative me direktivat e BE-së në fushën e ndryshimeve klimatike në vitin 2017
- Raportimi vjetor i inventarit GHG-ve Agjencisë Evropiane të Mjedisit në përputhje me kërkesat e raportimit UNFCCC

⁹ Projektionet e tanishme të emisioneve GHG për 2020 tregojnë vlerën 18,000 Gg CO₂ eq. Ky projektion do të rishikohet gjatë 2014/2015 në kuader të Komunikimit të tretë Kombëtar të UNFCCC. Në rast të angazhimit të fondeve ndërkombëtare për NAMAs, (Masat Kombëtare përkatëse për Reduktimit të GHG), reduktimi i GHG mund të rritet me 16% krahasuar me skenarin bazë.

- Integrimi i objektivave të përshtatjes dhe zbutjes në planifikimin fizik, menaxhimin e ujrave dhe menaxhimin e tokës duke përfshirë bujqësinë, pyjet, ujerat dhe ruajtjen e natyrës.

- Zhvillimi i Planit të menaxhimit të zonës bregdetare

- Zhvillimi i Inventarit të pyjeve dhe integrimi i shërbimeve të ekosistemit në sistemin e planifikimit të pyjeve dhe të sistemit informacionit, duke përfshirë sekuestrimin e karbonit, mbrojtjen e biodiversitetit të pyjeve, rritjen e sasisë dhe cilësisë së ujrave dhe parandalimin e zjarreve në pyje.

- Zbatimi i masave adaptuese në sektorin bujqësor

5. Brenda viti 2015 të fillojë procesi i rishqyrtimit të lejeve mjedisore të integruara të tipit A dhe miratimi i planeve të perputhshmerisë për 100% të operatoreve industriale, krahasuar me vitin 2012

Në fushën e mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit nën-objektivat sektoriale janë:

- Adresimi i shkaqeve të humbjes së biodiversitetit duke integruar çështjet e biodiversitetit në kontekst ndërsektorial dhe në shoqëri.

- Reduktimi i presionit direkt mbi biodiversitetin dhe promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të tij.

- Përmirësimi i statusit të biodiversitetit përmes ruajtjes së ekosistemeve, habitateve llojeve dhe biodiversitetit gjenetik.

- Zgjerimi i përfitimeve për të gjithë nga shërbimet e biodiversitetit dhe të ekosistemeve.

- Zgjerimi i zbatimit nëpërmjet planifikimit me pjesëmarrje dhe gjithëpërfshirës të menaxhimit dhe ndërtimit të kapaciteteve.

Këto objektiva specifike do të arrihen nëpërmjet masave të mëposhtme:

5.1 Arritja e përafrimit të plotë të direktivave të fushës së mbrojtjes së natyrës, biodiversitetit dhe peizazhit.

- Përafrimi i plotë i Direktivës së Habitaveve 92/43/EEC, nëpërmjet hartimit të akteve nënligjore - Vendimit të Këshillit të Ministrave;

- Përafrimi i plotë i Direktivës së Shpendëve (2009/147/EC) nëpërmjet hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore të planifikuara në PKIE si akte nënligjore të Ligjit “Për mbrojtjen e faunës së egër” dhe të Ligjit “Për gjuetinë”: Vendime të Këshillit të Ministrave, Udhëzime dhe Rregullore të Ministrisë së mjedisit;

- Transpozimi i Direktivës “Për mbajtjen e kafshëve në Kopshtet Zoologjike”;

- Zbatimi në praktikë i Rregullores 338/97 të BE-së për trejetinë ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër;

- Aderimi i Shqipërisë në Konventën Evropiane të Peizazhit;

5.2 Rritja e sipërfaqes së Zonave të Mbrojtura në 17 % të sipërfaqes tokësore të vendit dhe shtimi i sipërfaqes së Zonave të Mbrojtura detare dhe bregdetare në nivele të njëjta me mesataren e vendeve të BE-së dhe Aichi targets të Konventës së biodiversitetit;

- Shtimi i sipërfaqes së Zonave të Mbrojtura nëpërmjet shpalljes së një zone të mbrojtur ose zgjerimit të një zone të mbrojtur ekzistuese çdo vit për shtimin e sipërfaqes së Zonave të Mbrojtura;
- Përgatitja e dokumentit strategjik për zonat e mbrojtura detare dhe bregdetare në Shqipëri;
- Përgatitja e studimeve dhe hartës GIS për zona të veçanta të identifikuara për t'u shpallur Zona të Mbrojtura detare dhe bregdetare.
- Zgjerimi i rrjetit ekzistues të monitorimit të biodiversitetit sipas indikatorëve të rekomanduar nga Agjencia Evropiane e Mjedisit për fushën e natyrës.

5.3 Hartimi dhe zbatimi i planeve të menaxhimit të zonave të mbrojtura dhe planeve të veprimit të llojeve dhe habitateve dhe përgatitjet për Natura 2000.

- Përfundimi i hartimit të Planeve të Menaxhimit për 6 Zona të Mbrojtura në kuadër të projektit SELEA;
- Zbatimi i Planeve të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura, për ato ZM që tashme kanë plane të tilla të miratuara, në përputhje me planifikimin e shpenzimeve në PBA si dhe financime të mundshme të projekteve të donatorëve.
- Identifikimi i zonave të mundshme që plotësojnë kriteret për t'u shpallur Natura 2000 sites për Shqipërinë.
- Identifikimi i Rrjetit Ekologjik Kombëtar si pjesë përbërëse integrale e Rrjetit Ekologjik Pan-European;
- Rishikimi dhe përditësimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiversitetin (SPVB) për Shqipërinë në linjë me Planin Strategjik Global të Konventës së Biodiversitetit dhe përgatitja e Raportit të Pestë Kombëtar për Konventën e Biodiversitetit;
- Rishikimi dhe përditësimi i statusit të llojeve të mbrojtura dhe përditësimi i Listës së Kuqe të Florës dhe Faunës së Egër të Shqipërisë;

10) Objektivat dhe **produktet madhore ne fushen e mbetjeve** ne menyre te detajuar jane te parashikuara ne Strategjine dhe Planin Kombetar te Menaxhimit te Integruar te Mbetjeve.

- Me financim te KfW:Do te hartohet - studimi i fizibilitetit per ndertimin e landfillit Vlore;
- Do te fillojendertimi i landfillit per qarkun e Korçes.
- Fillimi i mbylljes se venddepozitimit ekzistues te Shkodres.
- Transpozimi i direktivave te Komunitetit European.
- Asgjesimi ne menyre te kontrolluar ne landfill ne masen 35 %.
- Gjithashtu do te filloje nga operimi, landfilli i Bajkaj ne Sarande, i cili eshte financuar nga Banka Boterore.
- Riciklimi i mbetjeve urbane ne masen 10 %. Transpozimi i direktivave te Komunitetit European. Hartimi i studimit te fizibilitetit per percaktimin e nje venddepozitimi per mbetjet e rrezikshme.

Hartimi i planeve rajonale te menaxhimit te mbetjeve.

- Fillimi i mbylljes se venddepozitimit ekzistues te Shkodres. Transpozimi i direktivave te Komunitetit Europian. Asgjesimi ne menyre te kontrolluar i mbetjeve qe shkojne ne landfill ne masen 37 %, riciklimi i mbetjeve urbane ne masen 20 %. Hartimi i planeve rajonale te menaxhimit te mbetjeve.
- Fillimi i mbylljes se venddepozitimit ekzistues te Durresit dhe Sarandes. Fillimi i ndertimittelandfillit te Sarandes. Transpozimi I direktivave te Komunitetit Europian. Asgjesimi i mbetjeve qe shkojne ne landfill ne masen 40%. Riciklimi I mbetjeve te ngurta urbane ne masen 25 %. Ndertimi i landfillit per menaxhimin e mbetjeve te rrezikshme.

Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizimit eshte ne perfundim te procesit te krijimit te nje sistemi te integruar dhe interaktiv (harte dhe databaze), i cili permban te dhena reale mbi gjendjen egzistuese te venddepozitimeve aktuale ne 61 Njese te Qeverisjes Vendore (NJQV). Te dhenat perfshijne elemente te zhvillimit te territorit sikurse: distancat nga qendrat e banuara, koordinatat, genplani, numri i popullsisë etj. Ky sistem “Harte dhe Databaze”, duke ndjekur situaten reale ne terren do te sherbeje si nje mjet planifikimi per rehabilitimin e venddepozitimeve aktuale te rrezikshme. Sistemi eshte hartuar ne menyre te tille qe te jete i vlefshem dhe i dobishem edhe ne kushtet te reja te reformes administrativo – territoriale.

Per Pyjet e Kullotat

Objektivat afatmesme 2015 - 2017 përfshijnë:

1. Përmirësimi ligjor e institucional për tu përgjigjur ndryshimeve ne strukturën e pronësisë mbi pyjet dhe atyre te lidhura me qeverisjen e pyjeve, duke arritur në masën 80% të përputhëshmerise së akteve ligjore me legjislacioni EU ne fushën e pyjeve dhe kullotave.

- a. Transpozimi i kuadrit ligjor Shqiptar me ato evropiane te lidhura me mekanizmat e hedhjes ne treg te lendes drusore nga pyje te certifikuar si dhe te reduktimit te prerjeve ilegale dhe tregtisë se lidhur me te.
- b. Miratimi i ligjit te Pyjeve dhe Kullotave si dhe e akteve te tjera nënligjore e rregullatorë,
- c. Zbatimi i reformës institucionale, bazuar ne ndarjen e funksioneve dhe atë rajonale;
- d. Krijimi i qendrës se zhvillimeve teknologjike e inovacioneve ne pyje;
- e. Krijimi i forumit të pyjeve (gjithëpërfshirës) për diskutimin e sigurimin e mbështetjes për politikat pyjore e vendimeve madhore të lidhura me zhvillimin e pylltarisë në vend;

2. Sigurimi i te drejtave tradicionale te përdorimit/pronësisë mbi pyjet, duke vendosur mekanizma për reduktimin e prerjeve ilegale dhe tregtimit te lendes drusore, në masën 50 % si dhe parandalimi i zjarreve ne masën 37 % te sipërfaqes se rrezikuar.

- a. Përcaktimi i një metodologjie për decentralizimin e kontrollit mbi pyjet dhe vendosjen e raporteve te drejta ndërmjet pyjeve te komunitetit, private e shtetërore;

- b. Përcaktimi i instrumenteve ekonomike e financiare për te vene ne eficiente sektorim e pyjeve;
- c. Përcaktimi i njësive te këmbimit te shërbimit ne ekosistem ne kushtet e ekonomisë se tregut dhe ekonomisë se gjelbër.

3. Rritja e efektivitetit ekonomik dhe e eficiencës energjetike nga përdorimi i qëndrueshëm i pyjeve shtetërore, rritjen e sipërfaqes pyjore nëpërmjet pyllëzimit dhe ripyllëzimit me arrore e pyjore për një sipërfaqeje prej 6000 ha, ngritja e një fidanishte pyjore për sigurimin e 4000000 fidanëve arrore e pyjor për mbjellje. Kryerja e punimeve silvikulturore për përmirësimin e grumbujve pyjor me ndërhyrje ripërtëritëse për 3000 ha pyje. Përmirësim kullotash duke realizuar deri 41% te sipërfaqes se planifikuar. Forcimi i kapaciteteve për menaxhimin e qëndrueshëm dhe shumë funksional te fondit pyjor dhe kullosor.

- a. Pyllëzimi në zona pilote me kultura intensive (short-rotation) për prodhim biomase dhe uljen e efekteve negative të ngjarjeve ekstreme natyrore (përmbytjeve).
- b. Nxitja e projekteve konkurruese dhe ekonomikisht eficiente në rehabilitimin e pyjeve dhe vlerësimin e materialit të vdekur të mbetur në pyll.
- c. Forcimi i partneritetit publik, privat dhe mbështetja e kompanive të specializuara e licencuara për tregtimin e materialit drusor,
- d. Krijimi i fondit te pyllëzimeve për esenca pyjore-arrore dhe hartimi i rregullores se funksionimit.

4. Vendosja e sistemit te shërbimeve ne ekosistem dhe adaptimi kundrejt ndryshimeve klimatike.

- a) Pylltaria dhe sekuestrimi i karbonit
- b) Pylltaria dhe mbrojtja e biodiversitetit pyjor,
- c) Pylltaria ne funksion te shtimit te sasisë dhe cilësisë se ujit.

5. Përmirësimi i planifikimit të sektorit të pyjeve dhe sistemit të informacionit të data bazës pyjore, hartuar dhe miratuar plane mbarështimi, azhurnimi i të dhënave të tyre duke realizuar 37% të objektivit si dhe krijimi i njësive territoriale me funksion prodhues dhe menaxhimi i integruar i tyre nëpërmjet teknikave te avancuara.

- a. Krijimi i njësive territoriale me funksion prodhues dhe menaxhimi i integruar i tyre nëpërmjet teknikave te avancuara;
- b. Harmonizimi i data bazës së pyjeve me ANFI dhe sistemin e FAO (EEA) në klasifikimin e vegjetacionit pyjor;
- c. Përmirësimi i metodologjisë, informacionit e teknologjisë së regjistrit (kadastrës) Pyjor dhe lidhje e tij automatike me sistemin GIS;
- d. Korrektimi i mbivendosjes së kufijve, krijuar nga procesi i transferimit të pyjeve komunale;
- e. Mbivendosja në hartë e planeve të menaxhimit të pyjeve komunale si harta e ngastrave, vegjetacionit aktual, pronësisë dhe punimeve;
- f. Përditësimi i të dhënave, bazuar në informacionet e ardhura dhe verifikimet e nivelit të besueshmërisë.

6. Forcimi i sistemit te kërkimit, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit ne pyje.

- a. Hartimi i një programi kombëtar për rivitalizimin e pyjeve dhe pylltarisë, duke siguruar dhe mbështetur rolin shumë funksional të pyllit, rivitalizuar pylltarinë dhe industrinë e drurit e afte të shfrytëzojë burimet rajonale, kontribuar në shoqëri me karbon të ulët, duke rritur përdorimin e drurit për material dhe energji.
- b. Hartimi i një strategjie dhe plani veprimi mbi Kërkimin, zhvillimin teknologjik dhe inovacionin në pyje;
- c. Ndërmarrja e një studimi mbi përlogaritjen e rritjes vjetore sipas klasave të vegetacionit;
- d. Ndërmarrja e një studimi mbi vlerësimin ekonomik të shumë-funksionalitetit në pyje;
- e. Ndërmarrja e studimeve për rehabilitimin e zonave të mëdha të djegura e të dëmtuara.

7. Përmirësimi i marrëdhënieve rajonale e me gjere, për shkëmbimin eksperiencave, aplikime të përbashkëta në programe ndërkombëtare dhe unifikimin e teknologjive e metodologjive në masën 50%.

- a. Forcimi i marrëdhënieve me shërbimet pyjore të vendeve të EU
- b. Forcimi i marrëdhënieve me shërbimet pyjore të vendeve të rajonit

8. Aplikimi në programe kombëtare e ndërkombëtare për të siguruar një mbështetje të nevojshme për zhvillimin e pylltarisë në vend.

- a. Hartimi i një projekti të ri në kuadër të mbështetjes së BB.
- b. Hartimi i një projekti me SNV për përcaktimin e një skeme financiare, për zhvillimin e pylltarisë komunale bazuar në mekanizmat e ndryshimeve klimatike etj.
- c. Hartimi i një projekti për reformën institucionale dhe sistemin e edukimit në pyje (Suedi)
- d. Përpilimi i një projekti për krijimin e dy fidanishteve pyjore Cërrik dhe Devoll

Ne fushën e ujerave

4. Menaxhimi i ujerave sipërfaqesore dhe nentokesore me qëllim reduktimin 95 % krahasuar me vitin 2011 të ndotjes së tyre,

- 4.1 Monitorimi i cilësisë së ujerave sipërfaqesore dhe nentokesore nga institucionet përgjegjëse në bashkëpunim me MM;
- 4.2- Monitorimi i sedimeneve në ujërat e lumëve dhe e rolit të tyre në gjeomorfologjinë e bregdetit.
- 4.3 Ritja e investimeve për monitorimin e cilësisë së ujerave sipërfaqesore, (ujërave detare, rritje e numrit të stacioneve dhe treguesve);
- 4.4 Forcimi i disiplinës së ligjit në mbrojtjen e mjedisit për aktivitetet që shkaktojnë ndotje të ujerave, si dhe ndaj atyre që shfrytëzojnë basenat ujore;
- 4.5 Forcimi i kapaciteteve inspektuese nëpërmjet trajnimeve që do të zhvillohen;

Objektivat afatgjatë (2017-2020)

Mbrojtja e mjedisit:

1. Në fushën e cilësisë së ajrit: Të reduktohen nivelet kombetare të NO_x 15%, të PM₁₀ me 50%, të PM_{2,5} me 25% krahasuar me nivelet e vitit 2013 përkatësisht: për NO_x - 40 µ/ m³, për PM₁₀ - 83 µ/ m³, të PM_{2,5}-33 µ/ m³ dhe të ruhen nivelet e vitit 2013 për SO₂ me 8 µ/ m³.

Produktet kryesore për arritjen e objektivave të cilësisë së ajrit:

- Arritja e transpozimit (100 %) të legjislacionit evropian në fushën e ajrit krahasuar me 21 % në vitin 2013;
- Modelet e makinave që vijne në Shqipëri të plotësojnë standardet Evropiane të emetimeve;
- Kontrolli i shkarkimeve të automjeteve si pjesë e procedurave vjetore të testimi të makinave i përmirësuar;
- Sistemi taksash i diferencuar për automjetet që përdorin karburante dhe makina të pastra kapacitetet e Inspektoratit Kombëtar të Mjedisit për kryerjen e matjeve të shkarkimeve nga burimet e palevizshme të përmirësuara;
- Djegia e pakontrolluar e mbetjeve urbane në ajër të hapur, në mënyrë spontane ose të qëllimshme, si kontribuesi më i rëndësishëm në emisionet e Dioksinave dhe Furaneve, të reduktuar.
- Plane lokale të cilësisë së ajrit të hartuara
- Inventari kombëtar i shkarkimeve të ndotësve në ajër i hartuar dhe përditësuar mbi bazë vjetore të konsoliduar.
- Baza e të dhënave për cilësinë e lëndës djegëse të hartuar dhe përditësuar çdo vit

Në fushën e zhurmave: Të reduktohet ndotja akustike me 30% në zonat kryesore urbane, krahasuar me vitin 2012 (vlerat mesatare të zhurmës gjatë periudhës së ditës të reduktohen nga 70 dB (A) në 56 dB dhe vlerat mesatare të zhurmës gjatë periudhës së natës të reduktohen nga 55 dB (A) në 45 dB(A).

Produktet:

- Ngritja dhe funksionimi i sistemit të monitorimit të zhurmave në mjedis
- Rritja e numrit të stacioneve të monitorimit të zhurmave nga 45 stacione egzistues në vitin 2012, në 60 stacione deri në vitin 2020.
- Studimi dhe Vlerësimi i gjendjes së sinjalistikës rrugore dhe hekurudhore për zhurmat dhe propozimi i masave konkrete për nderhyrje
- Vlerësimi dhe hartimi i një inventari kombëtar (data- base) mbi numrin e pajisjeve dhe makinerive që shkaktojnë zhurmë në mjedis dhe abdetimi i tij i përhershëm
- Forcimi i zbatimit të legjislacionit për zhurmat
- Arritja në 100% e përputhshmërisë së kuadrit normativ me rregulloret e BE në fushën e zhurmave në vitin 2020.

Në fushën e kimikateve: Funksionimi i sistemit kombëtar të menaxhimit të kimikateve në përputhje me rregulloret e BE-së, Konventën e Roterdamit dhe Sistemin Global të Harmonizuar (GHS); Arritja në 100% e përputhshmërisë së kuadrit normativ me rregulloret e BE në fushën e kimikateve deri në vitin 2020

Produktet

- Akte ligjore ne fushen e kimikateve te hartuara duke transpozuar 100% te legjislacionit te BE ne kete fushe
- Hartimi i udhëzuesve lidhur me incidentet industriale nga kimikatet e rrezikshme, menaxhimin e incidenteve, toksikologjine ne pergjithesi, masat e sigurisë dhe mbrojtjes nga kimikatet e rrezikshme, metodat e dekontaminimit, perdorimit te antidoteve apo pajisjeve ndihmese gjate ndodhjes se nje emergjence kimike
- Hartimi i procedurave për menaxhimin e kimikateve dhe materialeve të rrezikshëm si dhe metodat për eliminimin e mbetjeve të tyre nga labororet.
- Krijimi i bazave të të dhënave p.sh. për kimikatet e përdorur në industri (sasitë dhe llojet e mbetjeve industriale të reja që gjenerohen nga aktiviteti i subjekteve industriale të licënuara pas vitit 1992), për kimikatet e rrezikshme, si biocidet, PMB, për planet e emergjencave, etj.;
- Rritja e numrit te stafit që angazhohet me menaxhimin e kimikateve jo vetem ne numer, por nje staf cilësor, i aftë për të përballuar kërkesat e shumta të kësaj fushe që kërkon nivel shumë të lartë ekspertize.
- Organizimi i trajnimeve nga Qendra Kombetare e Trajnimit, ne nivel kombetar, rajonal dhe lokal per autoritetet kompetente dhe operatoret industriale per parandalimin, gadishmerine dhe pergjigjen ndaj emergjencave kimike.
- Organizimi i trainimeve dhe rritje e kapaciteteve të strukturave përgjegjëse për informimin mbi kimikatet.
- Aktivitete per rritjen e ndergjegjesimit te popullsisë mbi rrezikun kimikateve dhe e aksidenteve industriale te shkaktuara prej tyre.
- Hartimi i programeve trajnuese për inspektorët dhe stafet profesionale, metodologjikisht të konsoliduar si në trajtën e programeve të plotë për formimin e stafit të ri, ashtu edhe programe të shkurtër rifreskues.
- Aktivitete ndërgjegjësimi në të gjitha grupmoshat si dhe trajnimi i grupeve të ndryshme të profesionistëve, si fermerëve, transportuesve, industrialistëve, stafit teknik, si edhe i konsumatorit, për sigurinë në përdorimin e kimikateve.

Në fushën e ndryshimeve klimatike: Reduktimi me 8% te GHG krahasuar me skenarin baze¹⁰; (ii) reduktimi i sasisë se HCFC-ve me 40%;

Produktet:

- Reduktimi i substanceve qe hollonje shtresen e ozonit hidroklorofluorokarbone (HCFC) në 2020 ne 78 ton në krahasim me vitin 2011 ose me 120 ton / ne vit, me qëllim që të kontribuojë në parandalimin e ndryshimeve klimatike.
- Zbatimi i kërkesave të Traktatit të Komunitetit të Energjisë të ratifikuara nga Kuvendi duke përfshirë Planin e Veprimit per Eficencen e Energjisë.

¹⁰ Projektionet e tanishme te emisioneve GHG per 2020 tregojne vleren 18,000 Gg CO2 eq. Ky projektion do te rishikohet gjate 2014/2015 ne kuader te Komunikimit te trete Kombetar te UNFCCC. Në rast të angazhimit te fondeve nderkombetare per NAMAs, (Masat Kombetare perkatese per Reduktimte GHG), reduktimi i GHG mund te rritet me 16% krahasuar me skenarin baze.

- Mobilizimi i burimeve shitesë financiare ndërkombëtare për reduktimin e gazeve me efekt serrë (NAMA).
- Zbatimi i kërkesave të legjislacionit për energjinë e rinovueshme dhe eficienten e energjisë.
- Zbatimi i Skemës së Tregetimit të Emissioneve të BE-së.
- Zbatimi i programit për reduktimin e emisioneve të GHG-ve në Industrinë e Çimentos
- Arritja e sekuestrimi i karbonit nga pyjet
- Arritja e 100% të përputhjes të kornizës normative me direktivat e BE-së në fushën e ndryshimeve klimatike në vitin 2020.
- Integrimi i objektivave të përshtatjes dhe zbutjes në planifikimin fizik, menaxhimin e ujrave dhe menaxhimin e tokës duke përfshirë bujqësinë, pyjet dhe ruajtjen e natyrës.
- Objektivat e adaptimit të integruara në strategjitë dhe planet kombëtare sektoriale
- Objektivat e adaptimit të integruara në planet rajonale dhe lokale fizike dhe urbane, dhe strategjive të tjera lokale dhe programeve të tyre.
- Kthimi në gjendjen e meparshme të përmirësuar të pyjeve, duke përfshirë edhe mbrojtjen e biodiversitetit të pyjeve, rritjen e sasisë dhe cilësisë së ujrave dhe parandalimin e zjarreve në pyje.
- Identifikimi i vazhdueshëm i efekteve të ndryshimeve klimatike dhe zbatimi i masave për adaptim, me prioritet zonat më të ndjeshme bregdetare

Ne fushën e ndotjes - brenda viti 2020, 100% e operatorëve të medhenj industrialë të jenë në përputhje të plote me normat e shkarkimeve në ajër (PM10, SO2, NOx) dhe uje sipas kërkesave të ligjit "Për lejet mjedisore" dhe standarteve të përcaktuara në direktivave IPPC dhe LCP, krahasuar me vitin 2013.

Zbatimi i direktivave të fushës së mbrojtjes së natyrës dhe peizazhit

- Përfundimi i studimit për rrjetin Emerald të Zonave me Interes të Veçantë Ruajtjeje (ZIVR) në kuadër të Konventës së Bernës "Për ruajtjen e jetës së egër dhe të habitateve natyrore evropiane";
- Zbatimi i masave mbrojtëse për llojet dhe habitatet e listuara në Aneksin e Direktivës së Habitave dhe të Shpendëve;
- Zbatimi në praktikë i rregullores "Për mbajtjen e kafshëve në Kopshtet Zoologjike";
- Zbatimi në praktikë i Rregullores së BE-së për tregtinë ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të faunës dhe florës së egër;
- Zbatimi në praktikë e një sistemi gjithëpërfshirës të monitorimit të biodiversitetit;
- Rritja e sipërfaqes së Zonave të Mbrojtura detare dhe bregdetare në 6 % të sipërfaqes ujore të vendit në linjë me Aichi targets të Konventës së biodiversitetit për periudhën deri në 2020;
- Shpallja e dy Zonave të Mbrojtura detare në përputhje me dokumentin strategjik të hartuar dhe miratuar për këtë qëllim;
- Hartimi i Planeve të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura për zonat e reja të shpallura dhe përditësimi/rishikimi i planeve ekzistuese; përfshirja e çështjeve të ndryshimeve klimatike;
- Studim kombëtar për riklasifikimin e Zonave të Mbrojtura, bazuar në kriteret e reja të

- publikuara nga Unioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Natyrës (IUCN);
- Zbatimi i planeve të menaxhimit të zonave të mbrojtura dhe planeve të veprimit të llojeve dhe habitateve, identifikimi dhe studimi i zonave Natura 2000 për Shqipërinë;
- Zbatimi i masave konkrete të parashikuara në planet e menaxhimit për të siguruar statusin e favorshëm të ruajtjes për llojet dhe habitatet globalisht të kërcënuara;
- Përgatitja e propozimeve për zonat Natura 2000, për Shqipërinë sipas formatin standart të miratuar nga Komisioni Evropian;
- Zbatimi i planeve të menaxhimit të Zonave të Mbrojtura sipas buxhetit të alokuar në PBA dhe projekte të mundshme të donatorëve;
- Rehabilitimi i dunave dhe i ujëkëmbimit det - lagunë në zonat e mbrojtura bregdetare për të rritur aftësinë ripërtëritëse të ekosistemeve ndaj ndryshimeve klimatike;

Objektivat dhe produktet madhore **ne fushen e mbetjeve per periudhen 2015-2020** jane te parashikuara ne menyre te detajuar ne Strategjine dhe Planin Kombetar te Menaxhimit te Integruar te Mbetjeve.

- Zhvillimi i landfilleve rajonale. Mbyllja dhe monitorimi i venddepozitimeve egzistuese bashkiake. Transpozimi I direktivave te Komunitetit European. Asgjesimi I mbetjeve qe shkojne ne landfill ne masen 42%; riciklimi I mbetjeve urbane ne masen 30 %.
- Zhvillimi i landfilleve rajonale. Mbyllja dhe monitorimi i venddepozitimeve egzistuese bashkiake. Transpozimi I direktivave te Komunitetit European. Asgjesimi i mbetjeve qe shkojne ne landfill ne masen 45%; riciklimi I mbetjeve urbane ne masen 35 %.
- Zhvillimi i landfilleve rajonale. Mbyllja dhe monitorimi i venddepozitimeve egzistuese bashkiake. Transpozimi I direktivave te Komunitetit European. Zbatimi i sistemit te grumbullimit me tre kosha. Zbatimi i projekteve te ndarjes se mbetjeve te kompostueshme dhe te thata(leter, qelq, plastike, metal). Permiresimi i sistemit te grumbullimit te mbetjeve ne te gjitha zonat e mbetjeve. Asgjesimi I mbetjeve qe shkojne ne landfill ne masen 55%; riciklimi I mbetjeve urbane ne masen 45 %.
- Zhvillimi i landfilleve rajonale. Mbyllja dhe monitorimi i venddepozitimeve egzistuese bashkiake. Transpozimi I direktivave te Komunitetit European. Asgjesimi i mbetjeve qe shkojne ne landfill ne masen 50%; riciklimi i mbetjeve urbane ne masen 50 %.
- Zhvillimi i landfilleve rajonale. Mbyllja dhe monitorimi i venddepozitimeve egzistuese bashkiake. Transpozimi I direktivave te Komunitetit European. Asgjesimi I mbetjeve qe shkojne ne landfill ne masen 45%; riciklimi I mbetjeve urbane ne masen 55 %.

Pyjet dhe kullotat

Objektivat afatgjata 2017-2020 përfshijnë:

1. Brenda vitit 2020 ne legjislacionin kombëtar te arrihet transpozimi i plote i plote (100 %) i legjislacionit europian, ne fushën e pyjeve krahasuar. Sigurimi i kuadrit rregullator, institucional dhe ekonomik për zbatimin e menaxhimit te qëndrueshëm te pyjeve.
2. Sigurimi i te drejtave tradicionale te përdorimit/pronësisë mbi pyjet, duke vendosur

mekanizma për reduktimin e prerjeve ilegale dhe tregtimit të lëndës drusore, në masën 100 % si dhe parandalimi i zjarreve në masën 80 % të sipërfaqes së rrezikuar.

3. Rritja e efektivitetit ekonomik dhe e eficiencës energjetike nga përdorimi i qëndrueshëm i pyjeve shtetërore, rritjen e sipërfaqes pyjore nëpërmjet pyllëzimit dhe ripyllëzimit me arvore të pyjeve në masën 15% të sipërfaqes me bimësi pyjore dhe djerr, ngritja e një fidanishte pyjore për sigurimin e 4000000 fidanëve arvore të pyjeve për mbjellje. Kryerja e punimeve silvikulturore për përmirësimin e grumbujve pyjorë me ndërhyrje ripërtëritëse për 30000 ha pyje. Përmirësimi i kullotash duke realizuar deri 80% të sipërfaqes së planifikuar. Forcimi i kapaciteteve për menaxhimin e qëndrueshëm dhe shumë funksional të fondit pyjor dhe kullor në masën 100. Parandalimi i gërryerjes së mëtejshme të tokës pyjore dhe kullorore në 25 % të sipërfaqes, deri në 2020.

4. Vendosja deri në vitin 2020 të sistemit të shërbimeve në ekosisteme dhe adaptimi kundrejt

ndryshimeve klimatike në masën 100.

5. Realizimi i data bazën pyjore (GIS), hartimi dhe miratimi i planeve mbarështimit për

100% të fondit pyjor dhe kullor, azhurnimi i të dhënave të tyre duke realizuar 100% të objektivit si dhe përmbushja e krijimit të njësive territoriale me funksion prodhues dhe menaxhimi i integruar i tyre nëpërmjet teknikave të avancuara.

6. Forcimi i sistemit të kërkimit, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit në pyje.

7. Vendosja e marrëdhënieve rajonale e me gjere, për shkëmbimin e eksperiencave, aplikime

te përbashkëta në programe ndërkombëtare dhe unifikimin e teknologjive e metodologjive në masën 80%.

8. Sigurimi i mekanizmave financiare për të përmirësuar statusin e pyjeve dhe zhvillimin e sektorit të pyjeve.

Ne fushën e ujerave

Brenda vitit 2020 të arrihet plotësisht mbrojtja e ekosistemeve lumore,

- Te realizohet mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së ujerave nëpërmjet zbatimit të Planeve të Menaxhimit të Burimeve Ujore brenda vitit 2020;
- Monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së ujerave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga institucionet përgjegjëse në bashkëpunim me MM.

Kapitulli 4: Burimet financiare

Në përgatitjen e Dokumentit Strategjik Ndersektorial për mjedisin për periudhën 2013-2020, si dhe Dokumentin Strategjik Ndersektorial për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve janë mbajtur parasysh problematikat e ndeshura gjatë aktivitetit të viteve të kaluara dhe janë reflektuar me drejtë lidhjet ndërmjet objektivave, produkteve dhe aktivitetëve që duhet të realizohen për gjithë Ministrinë e Mjedisit. Janë zbatuar tavanet e paraqitura nga Ministria e Financës për të gjitha fondet e shpenzimeve buxhetore.

Në hartimin e këtyre dokumenteve janë patur parasysh një sërë kërkesash që lidhen me realizimin e

objektivave prioritare te qeverise ne fushen e mjedisit, pyjeve, ujrave dhe peshkimit si me poshte:

1. Forcimi i kontrollit per zbatimin e legjislacionit ne fushen e mjedisit, pyjeve,
2. Rehabilitimi i zonave te ndotura.
3. Permiresimi i cilesise se ajrit ne zonat urbane.
4. Mbrojtja nga erozioni nepermjet mbjelljeve te fidaneve pyjore dhe te ndertimit te pritave malore.
5. Ndalimi i prerjeve te paligjshme ne pyje dhe rritja e siperfaqeve te zonave te mbrojtura.
6. Ngritja e sistemi kombetar te menaxhimit te integruar te mbetjeve
7. Ngritja e sistemit te menaxhimit te kimikateve
8. Adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike
9. Parandalimin e zjarreve si dhe masat e nevojshme per shuarjen e tyre.

Fondet qe jane parashikuar ne arritjen e ketyre objektivave perfshijne pagat dhe pagesat e sigurimeve shoqerore per te gjithë stafin e MMPAU dhe strukturat vartese te miratuara me vendimet perkatese, pagesat per mallra dhe sherbimet e nevojshme per kryerjen e aktiviteteve, transferime korrente me entitetet brenda dhe jashte vendit dhe shpenzimet kapitale qe kane te bejne me projekte specifike me investime te brendshme dhe te huaja.

Disa nga projektet qe do te implementohen per realizimin e objektivave me financim te huaj perfshijne:

- Projekti: “Transformimi i tregut për përdorimin e paneleve diellore për ujë të ngrohtë në Shqipëri”;
- Projekti: “Identifikimi dhe zbatimi i masave për adaptim në deltën e lumenjve Drini- Mati”;
- Komunikimi i Tretë Kombëtar;
- Projekti GEF-UNDP “Menaxhimi i Zonave të Mbrojtura Detare dhe Bregdetare”;
- Projekti ”Zbatimi i kuadrit kombëtar për Biosigurinë në Shqipëri”;
- Projekti ”Rishikimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Biodiversitetit”;
- Projekti i ozonit;
- Projekti ”Forcimi i kapaciteteve të MMPAU për hartim dhe zbatim legjislativ”
Ndertimi i portit të ri të Peshkimit në Durrës;
- Projekti “Menaxhimi i Integruar i Ekosistemit të basenit të Prespes”;
- Projekti IPA 2010 - CEMSA Konsolidimi i sistemit të monitorimit në Shqipëri”;
- Projekti “Permiresimi i menaxhimit të burimeve natyrore ”
- Projekti i Cooperazione Italiana “Hartimi i planeve të menaxhimit të PK Shebenik-Jabllanice dhe Peizazhit të Mbrojtur Velipoje”.
- Projekti i JICA-s japoneze “Ruajtja e biodiversitetit në Parkun Kombëtar Divjake-Karavasta dhe hartimi i planit të menaxhimit të Parkut”;
- Projekti KfW-GIZ “Ruajtja e biodiversitetit në Liqenet e Shkodrës, Ohrit dhe Prespes”
- Projekti IPA 2013 (në proces negocijimi përfundimtar me Delegacionin Evropian);
- Projekti IPA CBC 2013 “Drejt forcimit të qeverisjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore të përbashkët ndërkufitare të Liqenit të Ohrit”(në proces negocijimi përfundimtar me Delegacionin Evropian);
- Projekti GEF për Zbatimin e Planit Strategjik shkretëtirezimit të tokës.

Ne fushen e mbetjeve financimi është parashikuar në dy faza:

Në Fazën e 1-re të financimit, do të sigurohet nëpërmjet programit të financimit të Qeverisë Qendrore dhe nëpërmjet financave të premtuara nga bashkësia kolektive e donatorëve ndërkombëtarë, goftë si donacione, apo si marrëveshjeve të posaçmefinanciare të kredisë. Këto fonde do të menaxhohen përmes mekanizmave të Qeverisë qendrore dhe bashkërendimit të njesise së donatoreve në Këshillin e Ministrave. Nëse këto fonde do të krijojnë një Fond Mjedisor kryesor ose jo është ende për t'u vendosur.

Në Fazën 2-te fondet do të vijnë kryesisht nga programi i fondeve të qeverisë qendrore dhe nga programet e infrastrukturës së fondeve të BE. Në çdo rast shpenzimet për zbatimin dhe përputhjen me Struktura të Direktivave të BE mbi mbetjet është llogaritur përafërsisht mes € 150 dhe € 200 milion, me kosto operative të shtuar vjetore prej rreth €52 milion në vit deri në vitin e 13-te pas zbatimit. Në mënyrë të detajuar buxheti për menaxhimin e integruar të mbetjeve jepet në Strategjinë dhe Planin Kombëtar të menaxhimit të mbetjeve.

Për më tepër detajim mund t'u referoheni tabelave bashkelidhur në lidhje me shpenzimet e parashikuara në programet buxhetore që është e organizuar Ministria e Mjedisit për zbatimin e politikave ndërsektoriale më të mëdha.

*ne
000/leke*

Buxheti i Ministrisë së Mjedisit për vitin 2015

Emertimi i Institucionit Buxhetor / Programit	600 - 601	602 - 606	Investim i brendshëm	Investim i huaj
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	74,564	104,200	18,000	
Programi për mbrojtjen e Mjedisit	377,296	56,300	612,898	364,615
Administrimi I Pyjeve	421,707	109,200	165,878	50,000
Administrimi I Ujrave	92,633	16,600	46,654	85,385
Totali	966,200	286,300	843,430	500,000

*ne
000/leke*

Parashikimi i Buxhetit të Ministrisë së Mjedisit për vitin 2016

Emertimi i Institucionit Buxhetor / Programit	600 - 601	602 - 606	Investim i brendshëm	Investim i huaj
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	74,564	104,200	20,000	
Programi për mbrojtjen e Mjedisit	400,000	56,300	612,898	364,615
Administrimi I Pyjeve	401,707	109,200	165,878	50,000
Totali	876,271	269,700	798,776	414,615

*ne
000/leke*

Parashikimi i Buxhetit të Ministrisë së Mjedisit për vitin 2017

Emertimi i Institucionit Buxhetor / Programit	600 - 601	602 - 606	Investim i brendshëm	Investim i huaj
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	74,564	104,200	20,000	
Programi për mbrojtjen e Mjedisit	400,000	56,300	612,898	364,615

Administrimi I Pyjeve	401,707	109,200	165,878	50,000
Totali	876,271	269,700	798,776	414,615

*ne
000/leke*

Parashikimi i Buxhetit te Ministrise se Mjedisit per vitin 2018				
Emertimi i Institucionit Buxhetor / Programit	600 - 601	602 - 606	Investim i brendshem	Investim i huaj
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	74,564	104,200	20,000	
Programi per mbrojtjen e Mjedisit	400,000	56,300	32,530	312,270
Administrimi I Pyjeve	401,707	109,200	155,000	120,000
Totali	876,271	269,700	207,530	432,270

*ne
000/leke*

Parashikimi i Buxhetit te Ministrise se Mjedisit per vitin 2019				
Emertimi i Institucionit Buxhetor / Programit	600 - 601	602 - 606	Investim I brendshem	Investim I huaj
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	74,564	104,200	20,000	
Programi per mbrojtjen e Mjedisit	400,000	56,300	32,530	312,270
Administrimi I Pyjeve	401,707	109,200	155,000	120,000
Totali	876,271	269,700	207,530	432,270

*ne
000/leke*

Parashikimi i Buxhetit te Ministrise se Mjedisit per vitin 2020				
Emertimi i Institucionit Buxhetor / Programit	600 - 601	602 - 606	Investim I brendshem	Investim I huaj
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	74,564	104,200	20,000	
Programi per mbrojtjen e Mjedisit	400,000	56,300	32,530	312,270
Administrimi I Pyjeve	401,707	109,200	155,000	120,000
Totali	876,271	269,700	207,530	432,270

Kapitulli 5: Llogaridhenia, monitorimi dhe analiza vleresuese Sistemi ekzistues i monitorimit:

Monitorimi i mjedisit kryhet ne perputhje me VKM Nr. 1189 date 18.11.2009 “ Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit” ku jane percaktuar organet qendrore dhe institucionet monitoruese per zbatimin e programit kombëtar te monitorimit.

Institucionet monitoruese, në bazë të programit, japin me hollësi dhe hartojnë projekte të veçanta për monitorimin e treguesve mjedisorë, të marrë përsipër prej tyre, të cilët i paraqesin në MMPAU si oferta. Projektet e institucioneve monitoruese shërbejnë si bazë për konkurrim dhe për

lidhjen e kontratave të monitorimit.

Institucionet monitoruese

- Agjencia e Mjedisit
- Instituti i Shëndetit Publik
- Instituti i Gjeoshkences, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit
- Fakulteti i Shkencave të Natyrës
- Sherbimi Gjeologjik Shqiptar
- Universiteti Bujqësor
- Universiteti i Tiranës, Shkodrës, Vlores.
- Instituti Hidrometeorologjik
- REC Shqiperi
- Agjensite e Basenve Ujembledhese
- Instituti i Peshkimit Durres
- Ministrite e linjes

Institucione bashkepunuese

Per te siguruar te dhenat per hartimin e inventarit kombetar te shkarkimeve ne ajer dhe inventarit kombetar te gazeve me efekt serre, kerkohet te institucionalizohet mbledhja e te dhenave nga institucionet qendrore te meposhteme:

- Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtise dhe Siper marrjes
- Ministria e Transportit dhe Infrastruktures
- Ministria e Bujqesise, Zhvillimi Rural dhe Administrimit te Ujrave
- Ministria e Mbrojtjes
- Ministria e Shendetesise
- Ministria e Financave
- Ministria e Kultures,
- Ministria e Puneve te Brendeshme
- INSTAT
- Ministria per Inovacionin dhe Administraten Publike

Te dhenat e grumbulluara nga monitorimi dhe analiza e rezultateve do te behet konform kerkesave dhe rekomandimeve te Direktives “INSPIRE” 2007/2/EC dhe ligjit Nr.72/2012

“Per organizimin dhe funksionimin e infrastruktures kombetare te informacionit gjeohapesinor ne RSH” .

Lista e treguesve:

Objektivi 1: (i) ulja me 40% e nivelit të ndotjes në zonat urbane; (ii) arritja e niveleve të ndotësve të ajrit, bazuar në shëndetin human, në vlerat përkatëse: për NO_x - 40 µ/ m³, për PM₁₀ - 40 µ/ m³, për PM_{2,5}-25 µg/m³ dhe 20 µg/m³ dhe SO₂-125 µ/ m³ per 24 ore ose 20 µ/ m³ ne vit..

Indikatorët:

- Reduktimi i përqendrimeve të PM10 dhe dioksidit të azotit brenda qyteteve kryesore të vendit.
- Numrin e diteve kur ndotja e ajrit është brenda normave ose më e lartë se standardet.
- Përqindja e popullatës që i nënshtrohet ekspozimit ndaj ndotjes së ajrit mbi normat e lejuara.

Zbatimi i indikatorëve baze mjedis/shëndet do të kryhet mbi bazën e bashkëpunimit ndër-institucional

Monitorimi i progresit do të përfshijë:

- Hartëzimi i burimeve kryesore të ndotjes, dhe krijimin e një baze të dhënash të shkarkimeve kombëtare në ajër.
- Vlerësimin e rezultateve të monitorimit të CAM për krijimin e zonave dhe grumbullimeve duke përfshirë planet e monitorimit.
- Implementimin e QA/QC për monitorimin e CAM.
- Përcaktimin e një Laboratori të Referencës Kombëtare për CAM.
- Kryerja e një vlerësimi paraprak.
- Hartimi i planeve për përmirësimin ose mirëmbajtjen e CAM në grumbullime dhe zona.

Objektivi 2:

- (i) reduktimi me 8% të GHG krahasuar me skenarin baze;
- (ii) reduktimi i sasisë së HCFC-ve me 40%;

1. Sasia vjetore në mij ton CO₂ e shkarkimit të gazeve me efekt sërre.
2. Sasia e substancës ozonholluese hidroklorflorkarbon (HCFC) do të reduktohen nga 120 ton në vitin 2010 në 78 ton në vitin 2020

Objektivi 3: Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së ujerave sipas legjislacionit të transpozuar në fuqi me qëllim reduktimin 95 % krahasuar me vitin 2011 të ndotjes së tyre.

Indikatorët:

5. Përqindja e rasteve të përputhjes së treguesve të cilësisë së ujerave; NBO5, NH4, O2 i tretur, NO3, P-total, me standardet evropiane të cilësisë së ujerave, është rritur: (i) nga 53% për NBO5, në 2011 në 55 % në 2012;
6. Përqindja e rasteve të përputhjes së treguesve të cilësisë së ujerave; NBO5, NH4, O2 i tretur, NO3, P-total, me standardet evropiane të cilësisë së ujerave, është rritur:(ii) nga 43% NH4 në 2011 në 45 % në 2012;
7. Përqindja e rasteve të përputhjes së treguesve të cilësisë së ujerave; NBO5, NH4, O2 i tretur, NO3, P-total, me standardet evropiane të cilësisë së ujerave, është rritur:(iii) nga 53% për P-total, në 2011 në 55 % në 2012
8. Përqindja e rasteve të përputhjes së treguesve të cilësisë së ujerave; NBO5, NH4, O2 i tretur, NO3, me standardet evropiane të cilësisë së ujerave(iv) për treguesit e O2 i

tretur, dhe NO3 te ruhen vlerat e 2011, te cilat jane brenda standarteve.

Objektivi 4: Asgjësimi i mbetjeve që shkojnë në landfill në masen 45% dhe riciklimi i mbetjeve urbane në masën 55%.

Indikatorët:

Indikatori 1. Përqindja e mbetjeve që shkojnë në landfille sanitare kundrejt mbetjeve të hedhura në venddepozitime të hapura është rritur nga 35 % në 2010 në 45% në 2020.

Indikatori 2: Rritja e sasisë së mbetjeve që riciklohen nga 10 % në vitin 2010 në 55% në vitin 2020.

Objektivi 5: Menaxhimi i qëndrueshëm i komponentëve mjedisore me qëllim miradministrimin e burimeve natyrore dhe mbrojtja e mjedisit në tërësi.

Indikatorët:

1. Ulja e prerjeve të pa ligjshme në pyje.
2. Sipërfaqja e fondit pyjor dhe kullësor mbuluar me plane mbarështimi nga 50 % në 2010 në 52 % në vitin 2012.
3. Monitorimi i cilësisë së ujërave dhe hartimi/zbatimi i politikave që përmirësojnë cilësinë e ujërave.

Objektivi 6: Mbrojtja dhe shtimi i biodiversitetit, zonave dhe llojeve të mbrojtura, me qëllim që të ruhet trashëgimia natyrore dhe kulturore e mjedisit;

Indikatorët:

1. Rritja e sipërfaqes së zonave të mbrojtura në shkallë vendi
2. Rritja e përqindjes së Zonave të Mbrojtura (Parqeve Kombëtare) me Plane Menaxhimi të miratuara
